



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 43

Tiranë – E enjte, 9 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 15/2017 datë 16.2.2017	Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë..... 2779
Ligj nr. 16/2017 datë 16.2.2017	Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995, “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar”..... 2788
Ligj nr. 17/2017 datë 16.2.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar..... 2788
Ligj nr. 18/2017 datë 23.2.2017	Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës..... 2815



LIGJ
Nr. 15/2017

**PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN
PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj:

a) përcakton parimet themelore të ofrimit, qeverisjes, financimit dhe menaxhimit të arsimit dhe të formimit profesional (AFP);

b) rregullon aspektet e sistemit të AFP-së në përputhje me sistemin e përgjithshëm arsimor dhe tregun e punës;

c) përcakton misionin dhe objektivat kryesorë të sistemit të AFP-së, si dhe rregullat për krijimin, organizimin, administrimin, financimin dhe mbylljen e ofruesve të AFP-së;

ç) përcakton rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve publike dhe subjektet e tjera përgjegjëse për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aspekteve të AFP-së.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

a) të krijojë dhe të zhvillojë një sistem të njësuar të AFP-së që t'u përgjigjet ndryshimeve social-ekonomike dhe teknologjike, në përputhje të plotë me nevojat e tregut vendas e global të punës;

b) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit dhe garantimit të cilësisë në institucionet e arsimit profesional, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;

c) të modernizojë sistemin e AFP-së, duke e bërë atë një mekanizëm më efektiv dhe më të efektshëm për rritjen e ritmeve të zhvillimit të

ekonomisë e të shoqërisë shqiptare, duke siguruar pajtueshmërinë e tij me sistemin arsimor dhe tregun e punës;

ç) të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në AFP.

Neni 3
Misioni i AFP-së

Arsimi dhe formimi profesional ka për mision:

a) të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik;

b) të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të teknologjisë, me kërkesat e tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare;

c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ministria përgjegjëse për AFP-në” është ministria që ka në fushën e saj të përgjegjësisë çështjet e AFP-së.

2. “Këshilli Kombëtar i AFP-së” është organi këshillimor që krijohet dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për AFP-në.

3. “Arsimi dhe formimi profesional (AFP)” është një fushë e aftësive profesionale, që kombinon arsimin me praktikën profesionale, e cila i pajis individët me njohuri e shprehi të veçanta, si dhe me kompetenca të gjera që kërkohen për t'u punësuar në një profesion të caktuar dhe për t'u integruar në tregun e punës.

4. “Sistemi i AFP-së” është sistemi, ku përfshihen të gjithë përbërësit e AFP-së dhe institucionet, të cilat e mbështesin atë, përfshirë dhe ofruesit e AFP-së.

5. “Ofrues i AFP-së” është institucioni publik ose jopublik (person fizik ose juridik), i licencuar dhe/ose i akredituar për të ofruar programe/shërbime të AFP-së në Republikën e Shqipërisë.



6. “Rezultatet e të nxënit” është një grup njohurish, shprehish dhe/ose kompetencash, që një individ i ka fituar dhe/ose është në gjendje t’i demonstrojë pas përfundimit të procesit të të mësuarit formal, joformal ose informal.

7. “Forma e dyfishtë e AFP-së” është një lloj i ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, i cili kombinon kualifikimin në një institucion të AFP-së me punën dhe aftësimin praktik në ndërmarrje, në bazë të përcaktimeve të një marrëveshjeje ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit (nxënësit) dhe ofruesit të AFP-së.

8. “Njësia e zhvillimit” është struktura e brendshme e ofruesit të AFP-së, e cila planifikon dhe realizon veprimtari zhvillimore në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të brendshme dhe rritjes së cilësisë.

9. “Kualifikimi profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies të një ofruesi të AFP-së, i përmbyllur me provime dhe i certifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (certifikatë).

10. “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK)” është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh për nivele specifike të të nxënit të përfutur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit e të cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

11. “Të nxënit” është procesi, nëpërmjet të cilit një individ përvetëson njohuri dhe zhvillon qëndrime, vlera dhe kompetenca.

12. “Të nxënit formal” është procesi i planifikuar, i organizuar dhe i institucionalizuar i të nxënit, i shoqëruar me certifikata të njohura zyrtarisht nga një autoritet kombëtar.

13. “Të nxënit joformal” është mësimnxënia që përfshihet në aktivitete të planifikuara dhe jo domosdoshmërisht të zhvilluara si forma mësimore në aspektin e objektivave mësimore, kohës dhe mbështetjes mësimore.

14. “Të nxënit informal” është procesi i paplanifikuar, i paorganizuar dhe i painstitucionalizuar i të nxënit, i cili nuk shoqërohet me certifikata të njohura zyrtarisht nga një autoritet kombëtar.

15. “Njohja e të nxënit të mëparshëm” është procesi i mësimnxënies, nëpërmjet të cilit rezultatet e të nxënit të një individi njihen zyrtarisht si aftësi dhe kompetenca, si nëpërmjet dhënies së një kualifikimi në formën e një certifikate, diplome apo titulli, ashtu edhe nëpërmjet dhënies së ekuivalencës, njësive të krediteve, vleftësimit të aftësive dhe/ose kompetencave të fituara.

16. “Të nxënit gjatë gjithë jetës” është i gjithë aktiviteti i mësimnxënies i fituar gjatë jetës, i cili çon në përmirësimin e njohurive, shprehive, aftësive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për arsye personale, shoqërore dhe/ose profesionale.

17. “Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

18. “Partnerët socialë” janë organizatat e punëdhënësve e të punëmarrësve që përfaqësojnë, sipas dispozitave të Kodit të Punës, të dyja anët e dialogut social dhe marrin pjesë e kontribuojnë në zhvillimin e sistemit të AFP-së.

19. “Qendra Shumëfunktionale e AFP-së” është një ofrues i arsimit dhe formimit profesional, që ka mandatin ligjor dhe kapacitetin për të ofruar arsim profesional të mesëm dhe pas të mesmes, si dhe formim profesional për të rinjtë e të rriturit.

20. “Korniza Europiane Referuese për Sigurimin e Cilësisë në AFP” përmban një cikël sigurimi dhe përmirësimi të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit të AFP-së, që mbështetet nga kriteret e përbashkëta të cilësisë, përshkruarit indikativ dhe treguesit.

21. “Akreditimi” është njohja formale që një institucion mund të kryejë detyrat për të cilat është licencuar. Akreditimi i një ofruesi të AFP-së është procesi i sigurimit të cilësisë së ofruesit që tregon se institucioni është i miratuar nga autoritetet përkatëse dhe që ka përmbushur standarde të paracaktuara.

22. “Sigurimi i cilësisë” është tërësia e aktiviteteve të planifikuara, të zbatuara, të vlerësuara e të raportuara, të cilat garantojnë që AFP-ja (përmbajtja e programeve, kurrikulat, vlerësimi dhe vleftësimi i rezultateve të të nxënit) është në përputhje me kriteret e cilësisë.

23. “Lista Kombëtare e Profesioneve” klasifikon profesionet, bazuar në llojin e punës e në kompetencat e nevojshme dhe përbëhet nga



emërtimet përkatëse të profesioneve/punëve e nga përshkrimet e profesioneve.

24. “Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve” është institucioni publik përgjegjës për krijimin e sistemit të unifikuar të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar, bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe për kualifikimin e trajnimit e vazhduar të mësuesve/instruktorëve të arsimit profesional.

Neni 5 Parimet

Sistemi i AFP-së bazohet në këto parime themelore:

a) Parimi i gjithëpërfshirjes: Sistemi i AFP-së ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim.

b) Parimi i autonomisë: Sistemi i AFP-së funksionon në bazë të autonomisë qeverisëse dhe financiare të ofruesve të AFP-së.

c) Parimi i cilësisë: Sistemi i AFP-së siguron cilësinë, sipas standardeve të miratuara e të përputhura me standardet ndërkombëtare për njohjen e kualifikimeve e të rezultateve të të nxënës.

ç) Parimi i bashkëpunimit: Sistemi i AFP-së funksionon në bazë të bashkëpunimit me subjekte të ndryshme publike dhe jopublike dhe në veçanti me partnerët socialë, të cilët janë të përfshirë në të gjitha nivelet e sistemit të AFP-së.

d) Parimi i garantimit të pjesëmarrjes: Sistemi i AFP-së krijon kushtet financiare, fizike dhe shoqërore për individët për të përfutur nga mundësitë e të nxënës gjatë gjithë jetës.

dh) Parimi i mobilitetit dhe vijueshmërisë: Sistemi i AFP-së garanton përputhjen e kurrikulave të lëndëve të arsimit të përgjithshëm që përfshihen në profilet e tij. Ai ofron mundësi për të gjithë nxënës për t’u transferuar në programe të tjera arsimi ose formimi dhe/ose për të vazhduar me marrjen e njohurive, kompetencave dhe aftësive, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

e) Parimi i diversitetit: Sistemi i AFP-së ofron lloje dhe nivele të shumëllojshme të kualifikimeve, të përshtatura për grupe të ndryshme, duke njohur njohuritë e tyre të përfuturara më parë.

KREU II

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

Neni 6

Kuadri institucional i sistemit të AFP-së

1. Sistemi i AFP-së përbëhet dhe administrohet nga institucione publike dhe jopublike që veprojnë në nivel qendror dhe vendor, përfshirë edhe ofruesit e AFP-së.

2. Autoritetet publike punojnë në partneritet me partnerët socialë dhe aktorë kryesorë të tjerë.

3. Ministria përgjegjëse për AFP-në, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve janë institucionet kryesore përgjegjëse për AFP-në në Shqipëri.

4. Roli i këtyre institucioneve, në kuadër të sistemit të AFP-së, përcaktohet nga ky ligj dhe nga aktet përkatëse nënligjore.

Neni 7

Ministria përgjegjëse për AFP-në

Ministria përgjegjëse për AFP-në ka këto kompetenca:

a) harton politika në fushën e AFP-së, si dhe monitoron zbatimin e tyre;

b) harton dhe propozon bazën ligjore e nënligjore në fushën e AFP-së;

c) monitoron dhe garanton cilësinë në sistemin e AFP-së;

ç) siguron burimet e nevojshme njerëzore, financiare e logjistike për funksionimin e AFP-së;

d) bashkëpunon me partnerët socialë në fushën e AFP-së;

dh) koordinon bashkëpunimin me institucione të tjera qendrore, të cilat janë përgjegjëse për aspekte të veçanta të AFP-së;

e) miraton hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e ofruesve publikë të AFP-së, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

ë) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Biznesit në procesin e licencimit të ofruesve privatë të AFP-së;

f) miraton hapjen dhe mbylljen e programeve, bazuar në kualifikimet kombëtare, të ofruara nga ofruesit publikë të AFP-së;

g) miraton procedurat për njohjen e njohurive të mëparshme;



gj) koordinon partnerët vendorë e ndër-kombëtarë që veprojnë dhe kontribuojnë në fushën e AFP-së;

h) miraton dokumentet themelore të kualifikimeve profesionale kombëtare;

i) përcakton procedurat për njohjen e mësimnxënies dhe kualifikimeve profesionale të niveleve 2 deri në nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, përfshirë ato të përfutuara jashtë vendit;

j) përcakton procedurat për njohjen e kualifikimeve profesionale për profesione të rregulluara, sipas direktivave të Bashkimit Europian.

Neni 8

Kompetencat e ministrisë përgjegjëse për arsimin e përgjithshëm

Ministria përgjegjëse për arsimin e përgjithshëm ka këto kompetenca:

a) miraton programet e kulturës së përgjithshme në bazë të kompetencave kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës;

b) organizon testimin dhe certifikimin e lëndëve përkatëse të Maturës Shtetërore Profesionale, nëpërmjet institucioneve të specializuara;

c) organizon aftësimin e vazhdueshëm profesional për mësuesit e kulturës së përgjithshme që janë të angazhuar në AFP;

ç) përcakton kriteret e përgjithshme për kualifikimin e mësuesve të lëndëve të arsimit të përgjithshëm në AFP.

Neni 9

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

1. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, veç detyrave të tjera të përcaktuara nga ligje të tjera, është përgjegjëse për aspektet e menaxhimit që lidhen me ofruesit publikë të AFP-së.

2. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është e ngarkuar me mbajtjen e një regjistri me certifikatat përfundimtare dhe me suplementet e certifikatave të lëshuara nga ofruesit e AFP-së dhe kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së.

3. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

1. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka këto kompetenca:

a) harton dhe mirëmban Listën Kombëtare të Profesioneve;

b) harton dhe mirëmban Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

c) harton programet kombëtare dhe materiale mbështetëse për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

ç) harton programet e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik;

d) monitoron kualifikimin e vazhduar të personelit mësimdhënës të kulturës profesionale të ofruesve të AFP-së;

dh) harton standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së;

e) akrediton ofruesit e AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së;

ë) përcakton kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për nxënësit në sistemin e AFP-së.

2. Organizimi dhe veprimtaria e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Këshilli Kombëtar i AFP-së

1. Këshilli Kombëtar i AFP-së është organ këshillimor që krijohet dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për AFP-në.

2. Përbërja, funksionimi dhe fusha e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të AFP-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Funksionet, kriteret e anëtarësimit dhe modalitetet e punës vendosen bashkërisht nga të gjithë partnerët dhe përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Ofruesit e AFP-së

1. AFP-ja ofrohet nga institucionet publike dhe private.



2. Institucionet ofruese të AFP-së janë:

- a) shkollat e mesme profesionale;
- b) qendrat shumëfunktionale të AFP-së;
- c) qendrat e formimit profesional;
- ç) institucionet e specializuara të AFP-së për grupet e veçanta;
- d) shoqëritë tregtare;
- dh) institucionet e tjera të licencuara dhe/ose të akredituara ose individët.

3. Ofruesit e AFP-së ofrojnë shërbimet e mëposhtme:

- a) programe të arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë dhe të rriturit;
- b) trajnim sipas kërkesës për ndërmarrjet;
- c) trajnim për aftësitë bazë, trajnim për kompetencat specifike kyçe;
- ç) njohjen e të nxënësve të mëparshëm;
- d) shërbime të tjera që lidhen me profilin e ofruesit.

4. Mënyra e organizimit dhe veprimtaria e institucioneve të AFP-së, përfshirë aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP-së dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të AFP-së, rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 13

Bordi Drejtues i ofruesve publikë të AFP-së

1. Bordi Drejtues i ofruesve publikë të AFP-së është një organ kolegjal, i cili merr vendime për drejtimin e përgjithshëm strategjik, planifikimin e përgjithshëm dhe përdorimin e burimeve njerëzore, financiare, materiale e fizike dhe mbështetjen e aktivitetit të administrimit të ofruesve publikë të AFP-së, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

2. Bordi përbëhet nga përfaqësues të sektorit publik dhe privat:

- a) dy përfaqësues të sektorit privat që lidhet me profilin e institucionit të AFP-së;
- b) një përfaqësues i njësisë arsimore vendore (drejtorisë rajonale/zyrës arsimore), që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale);
- c) një përfaqësues i këshillit të qarkut, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së;

ç) një përfaqësues i zyrës rajonale/vendore të punësimit, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së;

d) një përfaqësues i personelit mësimdhënës të institucionit publik, ofrues të AFP-së;

dh) një përfaqësues i nxënësve për shkollat publike të arsimit profesional ose një përfaqësues i punëmarrësve për qendrat publike të formimit profesional.

3. Bordi zgjedh kryetarin prej anëtarëve përfaqësues të sektorit privat.

4. Kriteret për pjesëmarrjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit Drejtues të ofruesve publikë të AFP-së përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 14

Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e ofruesve publikë dhe jopublikë të AFP-së

1. Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e ofruesve publikë të AFP-së bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-në.

2. Hapja dhe mbyllja e ofruesve jopublikë bëhet me miratimin e ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 15

Njësia e zhvillimit të ofruesit të AFP-së

1. Çdo ofrues i AFP-së ka njësi zhvillimi.

2. Njësia e zhvillimit ka këto funksione:

- a) zhvillimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve brenda institucionit;
- b) zhvillimin e kurrikulave në nivel ofruesi;
- c) krijimin e lidhjeve ndërmjet ofruesit dhe biznesit;
- ç) orientimin për karrierë të nxënësve/kursantëve;
- d) hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore;
- dh) zhvillimin e marketingut të ofruesit;
- e) mbledhjen e të dhënave të gjurmimit në nivel ofruesi.

3. Përbërja e njësisë së zhvillimit të ofruesit të AFP-së përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në, siç përcaktohet në nenin 12, pika 4, të këtij ligji.



KREU III
PËRMBAJTJA E AFP-së

Neni 16

Kualifikimet profesionale dhe nivelet përkatëse

1. Përfitimi, njohja dhe certifikimi i kualifikimeve profesionale në Shqipëri bazohet në standardet e kualifikimeve, të cilat përmbajnë njohuritë, shprehitë dhe kompetencat që duhet të arrijë nxënësi ose kursanti.

2. Kualifikimet profesionale përmbajnë nivelet 2, 3, 4 dhe 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;

b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;

c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);

ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;

d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit; dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

4. AFP-ja fillon pas përfundimit të arsimit bazë, ofrohet nga institucionet ofruese të AFP dhe është me kohëzgjatje 2 - 4-vjeçare. Sistemi i arsimit profesional ofron nivelet e mëposhtme:

a) Me përfundimin e arsimit profesional bazë, i orientuar sipas drejtimeve të gjera profesionale, me kohëzgjatje 2 vite shkollë pas përfundimit të arsimit bazë, mund të përftohet niveli 2 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë të përgatitjes bazë profesionale dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional ose në tregun e punës.

b) Me përfundimin e arsimit profesional, i orientuar sipas profileve profesionale për çdo drejtim profesional, me kohëzgjatje 2 vite shkollë, mund të përftohet niveli 3 dhe 4 i KSHK-së, pas përfundimit të arsimit profesional bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatën e punëtorit të kualifikuar, teknikut/menaxherit në profesionin përkatës dhe/ose me diplomën e maturës shtetërore profesionale, si dhe lejon kalimin në tregun e punës e në arsimin e lartë.

Neni 17

Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale

1. Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale përmban emërtimet, standardet dhe dokumente të tjera kombëtare përkatëse për secilin kualifikim, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat.

2. Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale miratohet nga ministri përgjegjës për AFP-në.

Neni 18

Lista Kombëtare e Profesioneve

1. Lista Kombëtare e Profesioneve hartohet dhe rishikohet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në bashkëpunim me partnerët socialë.

2. Lista Kombëtare e Profesioneve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Kurrikulat dhe programet e AFP-së

1. Kurrikulat e kualifikimeve profesionale të nivelit 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ndërtohen në formën e kurrikulave kombëtare, të cilat hartohen nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe më pas detajohen dhe zhvillohen në formën e kurrikulave në nivelin e ofruesit të AFP-së.

2. Formatet dhe procedurat kurrikulare të AFP-së përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 20

Transferimi horizontal dhe vertikal

1. Sistemi i AFP-së lejon transferimin horizontal dhe vertikal të përfituesve të AFP-së.

2. Transferimi horizontal i përfituesve të arsimit dhe formimit profesional konsiston në transferimin e përfituesit nga një drejtim/shkollë në një drejtim/shkollë tjetër.

3. Transferimi vertikal i përfituesve të arsimit dhe formimit profesional konsiston në transferimin e përfituesit nga arsimi i mesëm profesional në arsimin pas të mesëm.

4. Kushtet dhe procedurat për transferimin horizontal dhe vertikal brenda sistemit të AFP-së përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.



5. Kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm në arsimin profesional dhe anasjelltas përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit.

Neni 21

Njohja e të nxëniet të mëparshëm

1. Kompetencat e përfuara nga arsimi dhe formimi profesional joformal dhe informal vlerësohen në përputhje me standardet e profesioneve për kualifikimet profesionale.

2. Procedurat e vlerësimit e të certifikimit miratohen nga ministri përgjegjës për AFP-në.

3. Në rastet e individëve që kanë marrë një certifikatë, diplomë apo titull jashtë vendit, njësimi kryhet nga ministria përgjegjëse për AFP-në, në bazë të rregullave të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.

4. Sistemi i njohjes të të nxëniet të mëparshëm joformal dhe informal rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Forma e dyfishtë e AFP-së

1. Forma e dyfishtë e AFP-së ofrohet në bashkëpunim ndërmjet punëdhënësve dhe institucioneve përgjegjëse për AFP-në.

2. Mjedisi kryesor për përfundimin e kualifikimit profesional është vendi i punës, në bazë të një kontrate ndërmjet punëdhënësit dhe nxënësit (punëmarrësit), në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

3. Ofruesit e AFP-së ofrojnë mundësinë për plotësimin e kualifikimit profesional të nxënësit.

4. Kualifikimet afatgjata, të përfuara nëpërmjet formës së dyfishtë të AFP-së, janë pjesë e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

5. Për kualifikimet profesionale, të përfuara në fushën e veprimtarisë së zejeve, vlejnë dispozitat e ligjit të zejeve.

Neni 23

Këshillimi dhe orientimi i karrierës

Sistemi i AFP-së ofron shërbime për udhëzimin, këshillimin dhe orientimin e karrierës së nxënësve dhe kursantëve të vet për të lehtësuar punësimin e tyre, në bazë të rregullave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për AFP-në.

KREU IV

SIGURIMI I CILËSISË

Neni 24

Sistemi i sigurimit të cilësisë

1. Sigurimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm që synon të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të AFP-së. Ai përfshin licencimin, akreditimin dhe inspektimin e ofruesve të AFP-së, vetëvlerësimin, monitorimin dhe raportimin nga ofruesit e AFP-së, si dhe një vlerësim në intervale të caktuara të të gjithë sistemit të AFP-së nëpërmjet institucionit përkatës për AFP-në.

2. Procedurat për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve rregullohen me ligjin për KSHK-në.

Neni 25

Akreditimi

1. Akreditimi është një procedurë sistematike, së cilës i nënshtrohen ofruesit publikë të AFP-së. Ofruesit jopublikë të AFP-së i nënshtrohen një procesi akreditimi vetëm në rast se ofrojnë formim profesional për kualifikimet, të cilat shoqërohen me certifikatë të njohur nga ministria përgjegjëse për AFP-në dhe/ose kur aplikojnë për fonde publike.

2. Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së hartohen nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe miratohen nga ministria përgjegjëse për AFP-në.

Neni 26

Inspektimi

1. Inspektimi i ofruesve të AFP-së kryhet nga ministria përgjegjëse për AFP-në.

2. Inspektimi i aspekteve të kulturës së përgjithshme realizohet nga struktura përkatëse përgjegjëse për arsimin e përgjithshëm.

3. Dokumentacioni, procedura dhe kriteret për kryerjen e inspektimeve shtetërore të sistemit të AFP-së rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Sistemi kombëtar i informacionit për AFP-në

1. Sistemi kombëtar i informacionit për AFP-në zhvillohet dhe mirëmbahet nga ministria



përgjegjëse për AFP-në dhe agjencitë zbatuese.

2. Raportimi dhe publikimi i të dhënave zyrtare statistikore për sistemin e AFP-së është përgjegjësi e ministrisë përgjegjëse për AFP-në, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave.

KREU V

VLERËSIMI, PROVIMET DHE CERTIFIKIMI

Neni 28

Vlerësimi dhe provimet në AFP

1. Vlerësimet dhe provimet kryhen për të përcaktuar nëse rezultatet e të nxënësve, të shprehura në formën e njohurive, shprehive dhe sjelljeve, kanë arritur standardet e parashikuara.

2. Llojet dhe standardet e vlerësimit, përfshirë kriteret, procedurat, udhëzimet dhe kërkesat minimale, janë të rregulluara nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në bashkëpunim me partnerët socialë, dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.

3. Një nxënës i ri apo i rritur i nënshtrohet një provimi për marrjen e një kualifikimi profesional në një nivel të caktuar të KSHK-së, pas përfundimit të arsimit profesional, teorik dhe praktik, sipas formës së veçantë të ofrimit të AFP-së.

4. Komisionet e provimeve përfshijnë përfaqësues të biznesit apo ekspertë me përvojë teorike e praktike në fushën profesionale në fjalë, sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-në.

5. Në përfundim të nivelit 4 të KSHK-së, nxënësi merr Maturën Shtetërore Profesionale.

6. Organizimi dhe zhvillimi i provimeve në AFP rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 29

Certifikimi

1. Certifikata e kualifikimit profesional i lëshohet një individ, i cili i ka përmbushur standardet përkatëse të kualifikimit, pas një procesi vlerësimi formal.

2. Dokumentet e certifikimit lëshohen nga ofruesi i AFP-së.

3. Çdo certifikatë përfundimtare zyrtare në AFP shoqërohet nga një suplement i certifikatës, duke ndjekur udhëzimet e miratuara në BE dhe duke përshkruar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e përftuara nga mbajtësi i certifikatës.

Faqe | 2786

4. Llojet, procedurat dhe mënyrat për lëshimin e certifikatave, si dhe formatet që do të përdoren rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

KREU VI

FINANCIMI

Neni 30

Burimet e financimit

1. Arsimit dhe formimi profesional publik financohen nga:

a) Buxheti i Shtetit;

b) të ardhurat e gjeneruara nga vetë ofruesit publikë të AFP-së;

c) kontributet e donatorëve;

ç) sponsorizimet.

2. Mënyra e financimit nga Buxheti i Shtetit përcaktohet sipas procedurave ligjore në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe Ministrit të Financave.

3. Të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e arsimit dhe formimit profesional publik administrohen në masën 100 për qind nga vetë institucioni i arsimit dhe formimit profesional. Mënyra e gjenerimit dhe shpenzimit të tyre përcaktohet sipas parashikimeve të udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe Ministrit të Financave.

Neni 31

Aktivitetet fitimprurëse të ofruesve publikë të AFP-së

1. Ofruesit publikë të AFP-së funksionojnë si njësi ekonomike për të siguruar të ardhura nga aktivitetet e praktikave mësimore. Ata kanë të drejtë të investojnë dhe të rinvestojnë të gjitha të ardhurat e përftuara nga aktivitetet e tyre të ligjshme sipas rregullave të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.

2. Të ardhurat e ofruesve të AFP-së përfshijnë:

a) të ardhurat nga oferta e AFP-së, bazuar në kontrata të nënshkruara me të tretë;

b) të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve dhe i mallrave në treg;

c) të ardhurat nga dhënia me qira e mjediseve dhe pajisjeve, bazuar në kontrata qiraje ose kontrata të tjera;

ç) fondet kombëtare dhe të projekteve të financuara nga donatorë ndërkombëtarë sipas projekteve;



d) të ardhura të tjera që lejohen me ligj.

3. Të ardhurat e lartpërmendura janë në përputhje me qëllimet e institucionit, lidhen me profilet e ofruara dhe me qëllimet sociale dhe nuk duhet të përbëjnë qëllim fitimi në vetvete.

Neni 32

Alokimi i Buxhetit të Shtetit për ofruesit e AFP-së

1. Alokimi i Buxhetit të Shtetit për ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional bëhet bazuar në parashikimet për shpenzimet e personelit, përfshirë pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shpërblimet për performancë të mirë dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, shpenzimet operative përfshirë mallrat e konsumit, riparimet, shpenzimet e tjera operative për zhvillimin e praktikës dhe teorisë profesionale, aktivitete ekstrakurrikulare dhe funksionimin e institucionit, si edhe investimet, përfshirë ndërtimin dhe rindërtimin e ndërtesave, blerjen e pajisjeve të mëdha dhe veprimtari të tjera të lidhura me to.

2. Bursa është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një nxënësi për arritjet mësimore të tij ose sipas kriterëve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Llojet e bursave janë: bursat e studimit për nxënësit me arritje mësimore, bursat e studimit për nxënësit që ndjekin drejtime profesionale që janë prioritet kombëtar ose vendor, bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë. Masa, kriteret e përfutimit dhe procedurat e dhënies së bursave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pushteti vendor mund të ofrojë bursa për të ndjekur AFP-në në bashki të tjera në profile që përputhen me prioritetet vendore, sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 33

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 34

Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në nenin 35 të këtij ligji.

Neni 35

Miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, shkronja “e”; 9, pika 3; 10, pika 2; 11, pikat 2 e 3; 18, pika 2; 21, pika 4; 26, pika 3; dhe 32, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për AFP-në që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 4; 13, pika 4; 15, pika 3; 17, pika 2; 19, pika 2; 20, pika 4; 21, pika 2; 25, pika 2; 28, pikat 4 e 6; dhe 29, pika 4, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për AFP-në dhe Ministri i Financave që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin akte nënligjore në zbatim të nenit 30, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për AFP-në dhe ministri përgjegjës për çështjet e arsimit që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin akte nënligjore në zbatim të nenit 20, pika 5, të këtij ligji.

5. Ngarkohet ministri përgjegjës për pushtetin vendor që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 32, pika 3, të këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2017

Shpallur me dekretin nr. 10057, datë 6.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



LIGJ
Nr. 16/2017

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7918, DATË 13.4.1995, “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 1030, DATË 23.2.1995, “PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKËVE TË PRIVATIZIMIT)” DHE DEKRETIT NR. 1049, DATË 27.3.1995, “PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR. 1030, DATË 23.2.1995”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995, “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar”, fjalia e fundit e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“Afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2018.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2017

Shpallur me dekretin nr. 10058, datë 6.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 17/2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9947, DATË 7.7.2008, “PËR PRONËSINË INDUSTRIALE”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave” (në vijim DPPM) zëvendësohet me “Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale” (në vijim DPPI).

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

¹ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën 98/44/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 6 korrik 1998, “Mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike”; numri CELEX: 31998L0044, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 213, datë 30.7.1998, faqe 13-21.

- Direktivën (BE) 2015/2436 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2015, “Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me markat tregtare”; numri CELEX 32015L2436, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 336, datë 23.12.2015, faqe 1-26.

- Rregulloren (BE) nr. 1151/2012 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 21 nëntor 2012, “Mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”; numri CELEX: 32012R1151, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 343, datë 14.12.2012, faqe 1-29.

- Rregulloren (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 17 dhjetor 2013, “Për krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfaqëzohen Rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007”, të ndryshuar”; Numri CELEX: 32013R1308, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 347, datë 20.12.2013, faqe 671-854.



1. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. “Licencë ekskluzive” është licenca që pronari i një objekti të pronësisë industriale i jep ekskluzivisht vetëm një të licencuari të drejtën për ta përdorur atë.”.

2. Pas pikës 17/d shtohen pikat 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24 me këtë përmbajtje:

“18. “Mjet elektronik” është çdo mjet, me anë të të cilit mundësohet dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella apo të marra përmes kabllave, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, përfshirë dhe internetin.

19. “Mjedisi për aplikimin elektronik” është portali elektronik i DPPI-së, i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, e hapur nga DPPI-ja, ku mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror të DPPI-së, nëpërmjet mjeteve elektronike.

20. “Sistemi i administrimit të pronësisë industriale, SAPI” është mjeti elektronik, përfshirë dhe bazën e të dhënave, për administrimin e pronësisë industriale nga DPPI-ja.

21. “EO” është shkurtimi i shprehjes “Emërtim origjine”.

22. “EOM” është shkurtimi i shprehjes “Emërtim origjine i mbrojtur”.

23. “TGJ” është shkurtimi i shprehjes “Tregues gjeografik”.

24. “TGJM” është shkurtimi i shprehjes “Tregues gjeografik i mbrojtur”.

Neni 3

Në nenin 19, pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

“4. Aksesit në materialin biologjik të depozituar sigurohet nëpërmjet furnizimit të një kampioni:”

a) deri në publikimin e parë të aplikimit për patentë, vetëm ndaj atyre personave, të cilët janë të autorizuar, sipas parashikimeve të këtij ligji për patentat kombëtare;

b) ndërmjet publikimit të parë të aplikimit dhe dhënies së patentës, ndaj çdo personi që e kërkon atë ose, nëse aplikanti e kërkon kështu, vetëm ndaj një eksperti të pavarur;

c) pasi patentë është dhënë dhe pavarësisht nga revokimi ose anulimi i patentës, tek të gjithë që e kanë kërkuar atë.

5. Kampioni jepet vetëm nëse personi që e kërkon atë merr përsipër që gjatë kohës në të cilën patentë është në fuqi:

a) të mos ua vërë në dispozicion atë apo ndonjë material që rrjedh prej saj palëve të treta;

b) të mos e përdorë atë apo ndonjë material që rrjedh prej saj, përveç për qëllime eksperimentale, vetëm nëse aplikuesi ose pronari i patentës, sipas rastit, shprehimisht heq dorë nga kjo kërkesë.

6. Me kërkesë të aplikantit, kur një aplikim është refuzuar ose tërhequr, leja për materialin e depozituar kufizohet për një ekspert të pavarur për 20 vjet nga data kur është depozituar aplikimi për patentë. Në këtë rast do të zbatohet pika 5 e këtij neni.

7. Kërkesat e aplikantit referuar shkronjës “b”, të pikës 4, të këtij neni, dhe pikës 6, të këtij neni, mund të bëhen vetëm deri në datën në të cilën konsiderohet se kanë përfunduar përgatitjet teknike për publikimin e aplikimit për patentë.

8. Nëse materiali biologjik i depozituar në përputhje me këtë nen nuk është më i disponueshëm nga institucioni në të cilin është depozituar, një depozitë e re e materialit do të pranohet me të njëjtat kushte me ato të parashikuara në Traktatin e Budapestit.

9. Çdo depozitë e re shoqërohet me një deklaratë të nënshkruar nga depozituesi që vërteton se materiali biologjik i sapodepozituar është i njëjtë me atë të depozituar në fillim.”.

Neni 4

Në nenin 29, pika 1, fjalia “DPPM-ja mban regjistrin e patentave, ku regjistrohen të gjitha aplikimet, për të cilat është dhënë patentë.” zëvendësohet me fjalinë “DPPI-ja mban regjistrin e patentave, ku regjistrohen të gjitha aplikimet, për të cilat është dhënë data e depozitimit.”.

Neni 5

Në nenin 34, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. DPPI-ja e pranon kërkesën, pasi të jenë përmbushur kërkesat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për patentat, të dalë në zbatim të këtij ligji, si dhe pasi të jetë bërë pagesa e tarifës përkatëse, në të kundërt e refuzon atë.”.



Neni 6

Në nenin 35, pika 2, fjalia e dytë, pas fjalës “kërkesa” shtohen fjalët “shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse dhe”.

Neni 7

Pas nenit 36 shtohen nenet 36/a dhe 36/b me këtë përmbajtje:

“Neni 36/a

E drejta e pengut për patentat e shpikjeve

1. Patentat e shpikjeve mund të jenë objekt i një kontrate garancie ose pengu.

2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një kontratë e nënshkruar garancie ose pengu regjistrohet në regjistrin e patentave dhe publikohet në buletinin e DPPI-së.

3. Kontrata e përmendur në pikën 1, të këtij neni, prodhon efekt për palët e treta pasi të regjistrohet në regjistrin e patentave. Megjithatë, një kontratë e tillë mund të ketë efekt për një palë të tretë para sesa të regjistrohet, nëse provohet se ajo ka pasur dijeni për të. Pala e tretë nuk ngarkohet me barrën që të provojë dijeninë e saj.

4. Dispozitat e këtij neni për ndryshimet në lidhje me garancinë dhe pengun zbatohen si për kërkesën për patentë, ashtu dhe për kërkesën për certifikatën e mbrojtjes shtesë.

Neni 36/b

Procedura për zbatimin e veprimeve përmbarrimore

1. Patenta mund të jetë objekt i veprimeve përmbarrimore.

2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, e shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një veprim përmbarrimor regjistrohet në regjister dhe publikohet.

3. Një veprim përmbarrimor, i vendosur ndaj një patente, krijon pasoja juridike ndaj personave të tretë vetëm pas regjistrimit të tij në regjister dhe publikimit të tij në buletinin e DPPI-së, përveç kur regjistrimi i veprimit i njoftohet pronarit të patentës më parë me një njoftim zyrtar të DPPI-së.

4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e një veprimi përmbarrimor përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për patentat.

5. Dispozitat e këtij neni me ndryshimet përkatëse aplikohen edhe për certifikatën e mbrojtjes shtesë.”.

Neni 8

Në nenin 41, pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Nëse tarifa e ripërtëritjes nuk paguhet brenda afatit të lartpërmendur, ajo mund të paguhet brenda gjashtë muajve pas ditës së fundit të muajit, në të cilin përfshihet data e depozitimit, me kusht që brenda kësaj periudhe të paguhet një tarifë shtesë. Ky afat mund të zgjatet me dy muaj, duke paguar një tarifë shtesë për shtyrjen e afatit të ripërtëritjes. Nëse DPPI-ja konstaton se pronari i një patente nuk paguan tarifën e ripërtëritjes, sipas pikës 2, të këtij neni, ajo njofton pronarin apo përfaqësuesin e tij, brenda dy muajve nga data e mbarimit të këtij afati për mundësinë që ka për të bërë ripërtëritjen, sipas kësaj pike. Njoftimet bëhen vetëm në adresat që pronarët e patentave ose përfaqësuesit e tyre kanë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 35, kur nuk respektohen afatet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, patenta konsiderohet e mbaruar në datën e ripërtëritjes së saj.”.

Neni 9

Në nenin 116, pika 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) nëse kërkesa për regjistrimin e saj është bërë në keqbesim.”.

Neni 10

Në nenin 119, pika 2, pas fjalës “klasë” shtohen fjalët “edhe nën klasë”.

Neni 11

Pas nenit 119 shtohet neni 119/a me këtë përmbajtje:

“Neni 119/a

Ndarja e aplikimit të shumëfishtë

1. Paraqitësi i aplikimit mund të ndajë aplikimin e shumëfishtë në dy apo më tepër aplikime, të cilat mund të përmbajnë një ose disa diseno.



2. Secili aplikim i ndarë nga aplikimi i shumëfishtë do të ketë si datë depozitimi datën e depozitimit të aplikimit fillestar.

3. Kushtet për ndarjen e aplikimit të shumëfishtë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave për disenjot.”

Neni 12

Neni 121 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 121

Ekzaminimi i përmbushjes së kërkesave

1. Menjëherë pas marrjes së aplikimit për regjistrimin e një disenjoje, DPPI-ja ekzaminon nëse aplikimi përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 119. Nëse aplikimi i përmbush këto kërkesa, ai merr si datë depozitimi datën në të cilën aplikimi është paraqitur në DPPI. Nëse aplikimi nuk i përmbush të gjitha këto kërkesa, DPPI-ja njofton aplikuesin të plotësojë kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 119, brenda dy muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi i plotëson kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 119, brenda afatit, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit, duke caktuar si datë depozitimi datën në të cilën plotësimi i kërkesave formale të aplikimit është depozituar në DPPI. Nëse plotësimi i aplikimit nuk bëhet brenda këtij afati dymujor, DPPI-ja e refuzon depozitimin e aplikimit dhe njofton me shkrim për këtë aplikuesin.

2. Brenda tre muajve nga data e depozitimit të një aplikimi për regjistrimin e një disenjoje, DPPI-ja shqyrton aplikimin nëse përmbush kërkesat që parashikohen në pikat 2 dhe 3, të nenit 119, të këtij ligji. Kur aplikimi nuk i përmbush të gjitha këto kërkesa, DPPI-ja njofton aplikuesin t'i plotësojë ato brenda tre muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi nuk i plotëson kërkesat brenda afatit, DPPI-ja e refuzon aplikimin dhe njofton për këtë me shkrim aplikuesin.

3. Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas pikës 2, të këtij neni, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës tremujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.”

Neni 13

Në nenin 121/a bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Brenda tre muajve nga data e plotësimit të formaliteteve të parashikuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5, të nenit 119, DPPI-ja ekzaminon nëse disenjoja është në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 115, të këtij ligji. Kur aplikimi është në përputhje me të gjitha këto kërkesa të nenit 115, DPPI-ja publikon aplikimin për disenjo industriale në buletinin e DPPI-së.”

2. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas kësaj pike, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës dymujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.”

Neni 14

Në nenin 122, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. DPPI-ja publikon të dhënat e aplikimit, i cili përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 121/a, në buletinin e saj të radhës.”

Neni 15

Pas nenit 122 shtohen nenet 122/a dhe 122/b me këtë përmbajtje:

“Neni 122/a

Shfuqizimi ose ndryshimi i akteve administrative me gabime

1. Kur DPPI-ja ka marrë një vendim ose ka nxjerrë një akt administrativ në lidhje me një disenjo, i cili përmban një gabim të dukshëm të bërë nga vetë DPPI-ja, me kërkesë të palëve të interesuara ose me iniciativë të DPPI-së, kjo e fundit mund të shfuqizojë ose të ndryshojë aktin administrativ.

2. DPPI-ja merr vendim brenda dy muajve në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe njofton palët për vendimin e marrë.

3. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data që vendimi u njoftohet palëve.

Neni 122/b

Rivendosja në afat e të drejtave

1. Kur, për shkaqe e rrethana të veçanta të krijuara dhe në kundërshtim me vullnetin e tij,



aplikuesi i një disenjoje ose mbajtësi i një të drejte të një disenjoje nuk ka qenë në gjendje të respektojë një afat që sjell si pasojë të drejtpërdrejtë refuzimin e aplikimit për disenjo, aplikanti ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat.

2. Në kërkesën për rivendosjen në afat jepen shkaqet dhe rrethanat që kanë penguar aplikuesin ose mbajtësin e së drejtës të respektojë afatin. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 2 muajve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse.

3. Nëse kërkesa për rivendosje në afat pranohet, pasojat ligjore që shkaktohen nga mosrespektimi i afatit, konsiderohen se nuk kanë ndodhur.

4. Rivendosja në afat nuk lejohet për:

a) një kërkesë drejtuar Bordit të Apelit të DPPI-së;

b) një kërkesë drejtuar dhomës për shfuqizim /zhvlerësim;

c) një kërkesë drejtuar Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;

ç) kërkesën për rivendosje në afat, sipas këtij neni.

5. Procedura për depozitimin dhe shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat kryhet në mënyrën që përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për disenjo.

6. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja për rivendosjen në afat mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.”.

Neni 16

Neni 124 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 124

Procedura e kundërshtimit

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve shqyrton nëse kundërshtimi i depozituar është në përputhje me pikën 1, të nenit 123, të këtij ligji.

2. Nëse kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nuk plotësohen, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton paraqitësin e kërkesës.

3. Nëse kërkesa për kundërshtim plotëson kriteret e parashikuara në pikën 1, të këtij neni,

Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve njofton me shkrim dhe i dërgon një kopje të kundërshtimit aplikantit të disenjos, kundër së cilës është depozituar kundërshtimi, të paraqesë argumentet brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Afati kohor i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.

5. Nëse aplikanti nuk i paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit kohor të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve pranon kundërshtimin.

6. Nëse Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e konsideron të nevojshme, ajo mund të parashikojë mbajtjen e një seance dëgjimore për palët gjatë ndjekjes së procedurës së kundërshtimit.”.

Neni 17

Pas nenit 124 shtohet neni 124/a me këtë përmbajtje:

“Neni 124/a

Shqyrtimi i kundërshtimit

1. Nëse aplikanti i disenjos së kundërshtuar paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve brenda dy muajve shqyrton argumentet dhe bazën ligjore mbi të cilat mbështetet kundërshtimi.

2. Nëse gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimit Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve konstaton se kundërshtimi është i pabazuar, ajo refuzon kundërshtimin dhe vendimi i njoftohet aplikantit dhe kundërshtuesit.

3. Nëse gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve konstaton se kundërshtimi është pjesërisht i bazuar, regjistrimi i disenjos refuzohet ose pranohet pjesërisht.

4. Kundër vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të bëhet ankim në bordin e apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda një periudhe 1-mujore nga data e marrjes së vendimit.”.

Neni 18

Neni 126 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 126

Apelimi i vendimit të refuzimit

1. Brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e aplikimit për disenjo, sipas pikës 2, të nenit 121, dhe pikës 3, të nenit 121/a, të këtij ligji, aplikanti ka të drejtë, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, të apelojë vendimin e DPPI-së në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim.

2. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim shqyrton kërkesën për apelim, brenda një periudhe dymujore nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.

3. Gjatë shqyrtimit, dhoma për shfuqizim/zhvlerësim ka të drejtë t'i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe të parashikuar për këtë qëllim në rregulloren përkatëse.

4. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.”.

Neni 19

Pas nenit 129 shtohen nenet 129/a dhe 129/b me këtë përmbajtje:

“Neni 129/a

E drejta për vendosje pengu mbi një disenjo industriale

1. Disenjoja industriale është objekt mbi të cilin mund të vendoset pengu.

2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, kontrata e vendosjes së pengut mbi një disenjo industriale regjistrohet në regjistrin e disenjove.

3. Regjistrimi i vendosjes së një pengu publikohet në buletin e DPPI-së.

4. Pengu krijon pasoja juridike vetëm pas regjistrimit të kontratës së pengut në regjistër.

5. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e pengut përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për disenjo.

Neni 129/b

Procedura e veprimeve përbarimore

1. Disenjoja industriale mund të sigurohet dhe të jetë objekt i veprimeve përbarimore.

2. Me kërkesën e njëres nga palët, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një veprim

përbarimor i marrë ndaj një disenjoje regjistrohet në regjistrin e disenjove dhe publikohet në buletin e DPPI-së.

3. Një veprim përbarimor krijon pasoja juridike pas regjistrimit të veprimit përbarimor në regjistrin e disenjove.

4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e një veprimi përbarimor përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për disenjo.”.

Neni 20

Neni 138 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 138

Shfuqizimi i disenjosh

1. Personi i interesuar, përkundrejt tarifës përkatëse, mund t'i drejtohet dhomës për shfuqizim/zhvlerësim për të kërkuar shfuqizimin e një disenjoje të regjistruar, nëse ajo nuk i përmbush kushtet për t'u mbrojtur, sipas neneve 115 dhe 116, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) nëse është duke u zhvilluar një proces në lidhje me këtë disenjo në gjykatë, kërkesa duhet të bëhet në gjykatë;

b) kur, në çdo rast tjetër, kërkesa është bërë në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, personi, në çdo fazë të procedurës në DPPI mund t'ia drejtojë kërkesën gjykatës.

2. Disenjoja e regjistruar mund të mbahet në një formë të ndryshuar, nëse në formën e ndryshuar ajo i përmbush kërkesat për mbrojtje dhe identiteti i saj ruhet.

3. Çdo disenjo e regjistruar që shfuqizohet, zhvlerësohet nga data e depozitimit të saj.

4. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim merr vendim në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 3 muajve nga data plotësimit të pretendimeve, prapësimeve dhe paraqitjes së të gjitha provave nga palët.

5. Shfuqizimi i një disenjoje të regjistruar nuk mund të bëhet pa u thirrur për t'u dëgjuar pronari i saj.

6. Vendimi i dhomës për shfuqizim/zhvlerësim mund të ankimohet, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin e Apelit, brenda 1 muaji nga data që vendimi u njoftohet palëve.”.



Neni 21

Neni 140 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 140

Shenjat që mund të përbëjnë markë

Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta:

a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik;

b) të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj.”.

Neni 22

Në nenin 142 bëhen këto ndryshime:

1. Në titull, pas fjalës “refuzimi” shtohen fjalët “ose shfuqizimi”.

2. Në pikën 1, pas fjalës “markë” shtohet fjala “ose” dhe pas fjalës “nëse” shtohen fjalët “regjistrohet, mund të shfuqizohet kur:”.

3. Në pikën 1, shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) përbëhet nga elemente, që kanë prirje të çorientojnë publikun për natyrën, cilësinë, origjinën gjeografike ose tregtare të mallrave dhe/ose shërbimeve, që ato kanë për qëllim të dallojnë;”.

4. Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Një shenjë nuk përjashtohet nga regjistrimi si markë, në përputhje me shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 1, të këtij neni, në qoftë se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues në procesin e përdorimit përpara datës së aplikimit. Një markë tregtare nuk mund të zhvlerësohet për të njëjtat arsye, nëse, para datës së kërkesës për shfuqizim, për shkak të përdorimit të saj, ajo ka fituar karakter dallues.”.

Neni 23

Në nenin 143 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Refuzimi ose shfuqizimi për shkaqe relative”.

2. Në pikën 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) nëse kërkesa për regjistrimin e saj është bërë në keqbesim.”.

3. Në pikën 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Shkronjat “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“b) të drejtën e një individi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;

c) të drejtat e pronësisë industriale, emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;”.

ii) Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) të drejtat e një marke të paregjistruar ose një shenje tjetër, të fituara nga përdorimi për një kohë të gjatë në një aktivitet tregtar dhe shtrirja e gjerë territoriale.”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Kriteret në lidhje me markat e mirënjohura përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.”.

Neni 24

Në nenin 145 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kërkesa për të fituar të drejtën mbi një markë mund të bëhet nga çdo person.”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Pas datës së lëshimit të dëshmisë së depozitimit nga DPPI-ja, ndalohet të bëhen shtesa në listën e mallrave ose shërbimeve apo ndryshime në pamjen e markës, përveç rasteve që lidhen me bërjen e korrigjimeve ortografike ose saktësimeve në listën e mallrave ose shërbimeve.”.

Neni 25

Nenet 150 dhe 150/a ndryshohen si më poshtë:

“Neni 150

Ekzaminimi i përmbushjes së kërkesave

1. DPPI-ja ekzaminon kërkesat për regjistrimin e markave, sipas numrit rendor të paraqitjes së tyre.

2. Një kërkesë ekzaminohet jashtë numrit rendor, kur:



a) depozitohet një kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse;

b) është depozituar një kërkesë për ekzaminim jashtë numrit rendor, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

3. Menjëherë pas marrjes së aplikimit, DPPI-ja ekzaminon nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat e pikës 4, të nenit 145, të këtij ligji. Kur aplikimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e pikës 4, të nenit 145, DPPI-ja njofton aplikuesin t'i plotësojë ato brenda dy muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikimi plotësohet brenda afatit, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit, duke shënuar si datë depozitimi datën në të cilën paraqitet plotësimi i aplikimit në DPPI. Nëse plotësimi i aplikimit nuk bëhet brenda këtij afati dymujor, DPPI-ja e refuzon depozitimin e aplikimit dhe njofton me shkrim për këtë aplikuesin.

4. Brenda tre muajve nga data e lëshimit të dëshmisë së depozitimit për aplikimin për regjistrimin e një marke, DPPI-ja ekzaminon aplikimin nëse përmbushen kërkesat e pikave 1, 2, 3, 5 dhe 6, të nenit 145, të këtij ligji. Kur aplikimi nuk përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, të nenit 145, DPPI-ja njofton aplikuesin t'i plotësojë ato brenda tre muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi nuk i plotëson kërkesat brenda afatit, DPPI-ja e refuzon aplikimin dhe njofton për këtë me shkrim aplikuesin.

5. Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas pikës 4, të këtij neni, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës tremujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.

Neni 150/a

Ekzaminimi i shkaqeve absolute për refuzim

1. Brenda tre muajve nga data e plotësimit të kërkesave, sipas pikave 1, 2, 3, 5 dhe 6, të nenit 145, DPPI-ja ekzaminon nëse marka është në përputhje me kërkesat e neneve 140 dhe 142, të këtij ligji. Kur aplikimi është në përputhje me këto kërkesa, DPPI-ja publikon aplikimin për regjistrim marke në buletin e saj të radhës.

2. Nëse marka nuk është në përputhje me kërkesat e neneve 140 e 142, DPPI-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundësinë, brenda dy muajve nga data e njoftimit, të paraqesë shpjegimet

e tij, si dhe dokumente shtesë, sipas rastit. Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas kësaj pike, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës dymujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.

3. Nëse një markë përmban një element, i cili, sipas DPPI-së, nuk është dallues, dhe kur përfshirja e atij elementi të marka mund të ngrejë dyshime nëse marka mund të mbrohet ose jo, DPPI-ja mund t'i kërkojë aplikuesit, si kusht për regjistrimin e markës në fjalë, që të heqë dorë dhe të përjashtojë nga mbrojtja çdo të drejtë ekskluzive mbi atë element. Ky përjashtim duhet të regjistrohet dhe të publikohet së bashku me aplikimin ose regjistrimin e markës, sipas rastit.

4. Aplikimi refuzohet kur:

a) aplikuesi nuk paraqet shpjegimet e tij;

b) nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit kohor;

c) nëse DPPI-ja vëren se aplikimi nuk është në përputhje me përcaktimet e neneve 140 dhe 142, të këtij ligji, edhe pas shpjegimeve të aplikuesit.

Ky vendim i njoftohet aplikuesit.

5. Aplikimi nuk duhet të refuzohet përpara sesa t'i jetë dhënë aplikuesit njoftimi dhe afati përkatës që të paraqesë shpjegimet e tij ose përjashtimin nga mbrojtja të një elementi të markës ose ndryshimin e pranueshëm të elementit.”

Neni 26

Në nenin 151, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. DPPI-ja publikon të dhënat e aplikimit që plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në nenet 150 dhe 150/a në buletin e radhës.”

Neni 27

Pas nenit 151 shtohen nenet 151/a, 151/b dhe 151/c me këtë përmbajtje:

“Neni 151/a

Observime nga palët e treta

1. Brenda tre muajve nga data e publikimit të aplikimit për regjistrimin e një marke, çdo person i interesuar mund të paraqesë një kërkesë me shkrim në Dhomën për Shqyrtimin e Kundërshtimeve për shkaqe të bazuara në nenin 142, ku të përcaktojë se përse aplikimi nuk duhet të regjistrohet nga DPPI-ja.



2. Observuesi nuk bëhet palë e kësaj procedure dhe DPPI-ja nuk ka për detyrim ta informojë atë në lidhje me masat e marra për këtë observim.

3. Kërkesa, sipas pikës 1, të këtij neni, i komunikohet aplikuesit, i cili mund të paraqesë shpjegimet e tij në lidhje me këtë kërkesë brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

4. Kërkesa, sipas këtij neni, shqyrtohet brenda 2 muajve nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.

5. Kundër vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të bëhet ankim, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin e Apelit, brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 151/b

Shfuqizimi ose ndryshimi i akteve administrative me gabime

1. Kur DPPI-ja ka marrë një vendim ose ka nxjerrë një akt administrativ në lidhje me një markë, i cili përmban një gabim të dukshëm të bërë nga vetë DPPI-ja, me kërkesë të palëve të interesuara ose me iniciativë të DPPI-së, kjo e fundit mund të shfuqizojë ose të ndryshojë aktin administrativ.

2. DPPI-ja merr vendim brenda dy muajve në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe njofton palët për vendimin e marrë.

3. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data që vendimi u njoftohet palëve.

Neni 151/c

Rivendosja në afat e së drejtës

1. Kur për shkaqe e rrethana të veçanta, të krijuara në kundërshtim me vullnetin e tij, aplikuesi për regjistrim marke ose përfaqësuesi i tij nuk ka qenë në gjendje të respektojë një afat që sjell drejtpërdrejt si pasojë refuzimin e aplikimit për regjistrim marke, aplikuesi ka të drejtë të kërkojë të rivendoset në afat.

2. Kërkesa për rivendosjen në afat përmban shkaqet dhe rrethanat që kanë penguar aplikuesin të respektojë afatin. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 2 muajve nga dita kur janë eliminuar pengesat, të cilat kanë shkaktuar refuzimin e aplikimit, por jo më vonë se 1 vit nga

data e përfundimit të afatit të humbur. Kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse.

3. Nëse kërkesa për rivendosje në afat pranohet, pasojat ligjore që shkaktohen nga mosrespektimi afatit, konsiderohen se nuk kanë ndodhur.

4. Rivendosja në afat nuk lejohet për:

a) një kërkesë drejtuar Bordit të Apelit të DPPI-së;

b) një kërkesë drejtuar dhomës për shfuqizim /zhvlerësim;

c) një kërkesë drejtuar Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;

ç) kërkesën për rivendosje në afat, sipas këtij neni.

5. Procedura për depozitimin dhe shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat kryhet në mënyrën që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave për markat.

6. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja për rivendosjen në afat mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.”

Neni 28

Enet 152 dhe 153 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 152

Kundërshtimi ndaj një marke

1. Kundërshtimi ndaj një marke të publikuar depozitohet në DPPI brenda një periudhe tremujore nga data e publikimit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, nga:

a) aplikanti i një marke të mëparshme të depozituar në DPPI ose nga pronari i një marke të mëparshme;

b) pronari i një emri tregtar, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;

c) një person fizik, në bazë të përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;

ç) pronari i një të drejte të mëparshme të pronësisë industriale, në bazë të përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;

d) çdo person që ka të drejtën e autorit, sipas përcaktimit të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;

dh) përdoruesit e autorizuar të markave certifikuese;



e) nga cilido subjekt i sipërpërmendur në këtë pikë, që vërteton se aplikimi është bërë në keqbesim;

ë) përdoruesit e autorizuar ose të licencuarit e markës nga pronari i markës.

2. Periudha për paraqitjen e kundërshtimit nuk mund të zgjatet tej periudhës së parashikuar në pikën 1, të këtij neni.

3. Të dhënat për mënyrën e depozitimit të kundërshtimit dhe procedura e nevojshme parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

Neni 153

Procedura e kundërshtimit

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve ekzaminon nëse kundërshtimi është depozituar në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 152, të këtij ligji.

2. Nëse kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 152, nuk janë plotësuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton kundërshtuesin.

3. Nëse kërkesa për kundërshtim plotëson kriteret e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve njofton me shkrim dhe i dërgon një kopje të kundërshtimit aplikantit të markës, kundër së cilës është depozituar kundërshtimi, të paraqesë argumentet brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Afati kohor i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.

5. Nëse aplikanti nuk i paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit kohor të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e pranon kundërshtimin.

6. Kur Dhoma për shqyrtimin e Kundërshtimeve e konsideron të nevojshme, ajo fton palët në një seancë dëgjimore për t'i dëgjuar gjatë shqyrtimit të kundërshtimit.”.

Neni 29

Pas nenit 153 shtohet neni 153/a me këtë përmbajtje:

“Neni 153/a

Shqyrtimi i kundërshtimit

1. Nëse aplikanti i markës së kundërshtuar paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e

Kundërshtimeve shqyrton brenda dy muajve argumentet dhe bazën ligjore mbi të cilat mbështetet kundërshtimi.

2. Pas shqyrtimit të kundërshtimit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të vendosë që regjistrimi i markës që kundërshtohet të refuzohet ose të pranohet për të gjitha mallrat/shërbimet ose për një pjesë të tyre dhe vendimi i marrë në lidhje me këtë u njoftohet palëve.

3. Kundër vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të bëhet apelim në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, brenda një periudhe 1-mujore nga data e marrjes njoftim të vendimit.”.

Neni 30

Neni 155 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 155

Apelimi i vendimit të refuzimit

1. Brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e aplikimit, sipas neneve 150 dhe 150/a, të këtij ligji, aplikanti ka të drejtë, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, të apelojë vendimin e DPPI-së në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim.

2. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim shqyrton kërkesën për apelim, brenda tre muajve nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.

3. Gjatë shqyrtimit, dhoma për shfuqizim/zhvlerësim ka të drejtë t'i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhë të parashikuar për këtë qëllim në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

4. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet apelim në Bordin e Apelit, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.”.

Neni 31

Pas nenit 156 shtohet neni 156/a me këtë përmbajtje:

“Neni 156/a

Citimi i markave tregtare në botime

Nëse një markë tregtare e regjistruar përmendet në një fjalor, enciklopedi apo material të ngjashëm,



duke përfshirë dhe botimet elektronike, dhe shërben si referencë, duke dhënë përshtypjen e gabuar se marka tregtare përbën një emër përshkrues të mallrave apo shërbimeve, për të cilat është regjistruar, botuesi, me kërkesë të pronarit të markës tregtare, në botimin e ardhshëm tregon, me anën e një sqarimi tregues ose shenje, se kemi të bëjmë me një markë të regjistruar.”.

Neni 32

Pas nenit 163 shtohen nenet 163/a dhe 163/b me këtë përmbajtje:

“Neni 163/a

Regjistrimi i së drejtës së pengut mbi një markë

1. Marka mund të sigurohet ose të jetë objekt mbi të cilin mund të vendoset pengu.
2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, kontrata e vendosjes së pengut mbi një markë tregtare regjistrohet në regjistrin e markave.
3. Regjistrimi i vendosjes së një pengu publikohet në buletinin e DPPI-së.
4. Pengu krijon pasoja juridike vetëm pas regjistrimit të kontratës së pengut në regjistrin.
5. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e pengut përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

Neni 163/b

Procedura e veprimeve përmbartimore

1. Marka mund të jetë objekt i veprimeve përmbartimore.
2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një veprim përmbartimor i marrë ndaj një marke tregtare regjistrohet në regjistrin e markave dhe publikohet në buletinin e DPPI-së.
3. Një veprim përmbartimor krijon pasoja juridike pas regjistrimit të veprimit përmbartimor në regjistrin e markave.
4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e një veprimi përmbartimor përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.”.

Neni 33

Në nenin 164, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Marka e regjistruar mbrohet për një afat

10-vjeçar duke filluar nga data e depozitimit.”.

Neni 34

Nenet 173 dhe 174 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 173

Shfuqizimi i markës

1. Një markë e regjistruar mund të shfuqizohet kur:

- a) regjistrimi i markës është bërë në shkelje të parashikimeve të neneve 142 e 143, të këtij ligji, në kohën kur është depozituar aplikimi për regjistrim;
- b) aplikimi për regjistrimin e markës është bërë në keqbesim.

2. Kërkesa për shfuqizimin e një marke të regjistruar mund të bëhet nga çdo person, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- a) nëse është duke u zhvilluar një proces në lidhje me këtë markë në gjykatë, kërkesa duhet të bëhet në gjykatë;
- b) kur, në çdo rast tjetër, kërkesa është bërë në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, personi, në çdo fazë të procedurës në DPPI, mund t'ia drejtojë kërkesën gjykatës.

3. Çdo markë e regjistruar që shfuqizohet, konsiderohet si e paqenë, duke filluar nga data e depozitimit të markës. Kur marka, që nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” ose “c”, të pikës 1, të nenit 142, të këtij ligji, por ka fituar karakter dallues, në përputhje me pikën 2, të nenit 142, të këtij ligji, nuk shfuqizohet, por data e depozitimit do të zhvendoset në kohë në momentin që marka e ka fituar karakterin dallues.

4. Një markë nuk mund të shfuqizohet me arsyetimin se ekziston një markë e mëparshme, që është në konflikt me atë markë, nëse marka e mëparshme nuk përmbush kërkesat e nenit 159 të këtij ligji. Nëse marka tregtare e mëparshme është përdorur vetëm për një pjesë të mallrave apo shërbimeve, për të cilat është regjistruar, konsiderohet se ajo është regjistruar vetëm për këtë pjesë mallrash apo shërbimesh.

5. Kur arsyet për refuzimin e regjistrimit ose për shfuqizimin e një marke lidhen vetëm me disa mallra ose shërbime, për të cilat është paraqitur aplikimi apo është regjistruar marka, refuzimi i regjistrimit ose shfuqizimi mbulon vetëm ato mallra ose shërbime.



6. Shfuqizimi i një marke të regjistruar nuk mund të bëhet pa u thirrur për t'u dëgjuar pronari i saj.

7. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim merr vendim në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda dy muajve dhe njofton palët për vendimin e marrë.

8. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet ankim, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin e Apelit, brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

Neni 174

Zhvlerësimi i markës

1. Regjistrimi i një marke zhvlerësohet kur:

a) pronari i saj, pa pasur arsye legjitime, nuk e ka përdorur markën për mallrat ose shërbimet, për të cilat marka është regjistruar, për një periudhë të pandërprerë pesëvjeçare. Megjithatë, një palë e tretë nuk mund të kërkojë zhvlerësimin e markës për mospërdorimin e saj, nëse gjatë periudhës midis mbarimit të afatit 5-vjeçar të mospërdorimit dhe datës kur është ngritur padia për zhvlerësimin e markës, pronari i markës ka filluar ta përdorë markën ose ka rifilluar përdorimin e saj. Përdorimi i markës ose rifillimi i përdorimit të saj nga pronari i markës nuk do të merret parasysh, kur janë bërë jo më parë se tre muaj para ngritjes së padisë për zhvlerësimin e markës dhe jo më herët se me mbarimin e periudhës së pandërprerë pesëvjeçare të mospërdorimit, nëse pronari i markës fillon përdorimin ose ripërdorimin e markës për arsye se ka marrë dijëni për ngritjen e padisë për zhvlerësimin e saj;

b) si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të pronarit të saj, marka është bërë emër i zakonshëm në treg për mallrat ose shërbimet, për të cilat ajo është regjistruar;

c) si pasojë e përdorimit të bërë nga pronari ose me pëlqimin e tij të mallrave ose të shërbimeve, për të cilën ajo është regjistruar, marka çorienton publikun, kryesisht, për natyrën, cilësinë ose origjinën gjeografike të mallrave apo të shërbimeve.

2. Regjistrimi i një marke nuk zhvlerësohet, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, për mallrat dhe shërbimet, për të cilat ajo është regjistruar, kur:

a) është përdorur nga i licencuari ose një person tjetër, me lejen e pronarit të markës ose nga çdo

person, që ka autoritet të përdorë një markë kolektive;

b) është përdorur në një formë, që ndryshon vetëm ato elemente të markës, që nuk cenojnë karakterin dallues të saj, në formën që ajo është regjistruar;

c) i është ngjitur mallrave ose ambalazhimit të tyre në Republikën e Shqipërisë vetëm për qëllime eksporti;

ç) është përdorur për publicitet dhe korrespondencë biznesi, në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 159, të këtij ligji.

3. Kur shkaqet për zhvlerësimin e një marke lidhen vetëm me disa mallra ose shërbime, për të cilat marka është regjistruar, zhvlerësimi shtrihet vetëm për këto mallra ose shërbime.

4. Kërkesa për zhvlerësimin e një marke të regjistruar mund të bëhet nga çdo person, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) nëse është duke u zhvilluar një proces në lidhje me këtë markë në gjykatë, kërkesa duhet të bëhet në gjykatë;

b) kur, në çdo rast tjetër, kërkesa është bërë në Dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, personi, në çdo fazë të procedurës në DPPI, mund t'ia drejtojë kërkesën gjykatës.

5. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim njofton pronarin e markës, ndaj së cilës është depozituar kërkesa për zhvlerësim, dhe e fton atë të paraqesë, brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit, argumentet, provat ose çdo dokument tjetër në lidhje me kërkesën për zhvlerësim. Ky afat mund të zgjatet me kërkesë të pronarit të markës me dy muaj shtesë.

6. Zhvlerësimi i një marke të regjistruar nuk mund të bëhet pa u njoftuar pronari i saj.

7. Nëse dhoma për shfuqizim/zhvlerësim e konsideron të nevojshme, ajo mund të thërrasë palët për t'i dëgjuar në një seancë dëgjimore gjatë ndjekjes së procedurës së zhvlerësimit.

8. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim merr në shqyrtim kërkesën, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët dhe merr vendim brenda dy muajve, si dhe njofton palët për vendimin e marrë.

9. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet ankim, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin



e Apelit brenda 1 muaji nga data e marrjes së njofimit.

10. Çdo markë e regjistruar që zhvlerësohet i pushon efektet nga dita që zhvlerësimi hyn në fuqi.

11. DPPI-ja e pasqyron zhvlerësimin e një marke në regjistrin e markave.”.

Neni 35

Në nenin 175 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 4, fjalët “dita e parë e muajit pasardhës të muajit të publikimit të markës” zëvendësohen me fjalët “data e publikimit të aplikimit”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“6. Afati për paraqitjen e kundërshtimit nuk mund të zgjatet tej afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni.

7. Regjistrimet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen shqyrtimit për shkaqet absolute të refuzimit, ashtu siç i nënshtrohen edhe aplikimet kombëtare për regjistrimin e markës tregtare.

8. Nëse marka ndërkombëtare nuk është në përputhje me kërkesat e neneve 140 dhe 142, DPPI-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundësinë, brenda katër muajve nga data e publikimit të njofimit në gazetën zyrtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, të paraqesë shpjegimet e tij, si dhe dokumente shtesë, sipas rastit.”.

Neni 36

Pas nenit 175 shtohet neni 175/a me këtë përmbajtje:

“Neni 175/a

Transformimi i një regjistrimi ndërkombëtar

1. Regjistrimi ndërkombëtar i një marke mund të transformohet në aplikim për markë kombëtare, sipas nenit 9^{quinquies}, të Protokollit të Madridit, si dhe sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

2. Kërkesa për transformim, sipas nenit 9^{quinquies}, të Protokollit të Madridit, duhet të depozitohet pranë DPPI-së brenda 3 muajve nga data në të cilën regjistrimi ndërkombëtar është fshirë.

3. Periudha e mbrojtjes së markës së transformuar konsiderohet se fillon në datën e regjistrimit ndërkombëtar, sipas nenit 3(4), të Protokollit të Madridit, ose në datën e regjistrimit të shtrirjes territoriale, sipas nenit 3^{ter} (2), të Protokollit të Madridit, dhe, nëse regjistrimi ndërkombëtar gëzon prioritet, i njihet data e prioritetit.”.

Neni 37

Titulli i pjesës V ndryshohet dhe zëvendësohet me “Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës”.

Neni 38

Krerët XXX dhe XXXI ndryshohen si më poshtë:

“KREU XXX
PËRKUFIZIMI, KUSHTET DHE E DREJTA E
MBROJTJES

Neni 176

Objekti i mbrojtjes

1. Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, që përdoren në tregti për të treguar origjinën gjeografike të produkteve, mbrohen nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. “Emërtim origjine” quhet emri që identifikon një produkt:

a) që e ka origjinën nga një vend specifik, rajon apo, në raste të veçanta, një shtet;

b) cilësitë ose karakteristikat e të cilit vijnë, ekskluzivisht ose esencialisht, si rezultat i një mjedisi gjeografik të veçantë, që përfshin faktorët natyrorë dhe njerëzorë, të trashëguar nga ky mjedis;

c) hapat për prodhimin e të cilit realizohen në zonën e përcaktuar gjeografike.

3. “Tregues gjeografik” quhet emri që identifikon një produkt:

a) që e ka origjinën në një vend specifik, rajon apo shtet;

b) cilësitë, reputacioni ose karakteristikat e tjera të të cilit i atribuohen esencialisht origjinës së tij gjeografike;

c) të paktën një nga hapat prodhues të të cilit realizohet në zonën e përcaktuar gjeografike.

4. Disa emra tradicionale gjeografikë ose jogjeografikë, të përdorur për një produkt ushqimor ose bujqësor, të cilët e kanë origjinën në një rajon apo vend specifik dhe që përmbushin



kushtet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, trajtohen si emërtime të origjinës.

5. Në përjashtim të parashikimit të pikës 2, të këtij neni, disa tregues gjeografikë trajtohen si emërtime origjinë në rastin kur lënda e parë e produktit vjen nga një zonë gjeografike më e gjerë ose e ndryshme nga zona ku përpunohet produkti, me kusht që:

a) zona e prodhimit të lëndës së parë të jetë e përcaktuar;

b) të ekzistojnë kushte specifike për prodhimin e lëndës së parë;

c) të ekzistojnë rregullime për inspektimin që sigurojnë se këto kushte janë përmbushur.

Në kuptim të kësaj pike, vetëm kafshët e gjalla, mishi dhe qumështi mund të vlerësohen si lëndë e parë.

6. Në rastin e aplikimeve që kanë të bëjnë me pijet alkoolike, tregues gjeografik i një pijeje alkoolike do të jetë një tregues që identifikon një pije alkoolike me origjinë në territorin e një vendi ose një rajoni apo lokaliteti të këtij territori, ku një cilësi e dhënë, reputacioni apo karakteristika të tjera të asaj pijeje alkoolike i atribuohen esencialisht origjinës së tij gjeografike.

7. Në rastin e aplikimeve që kanë të bëjnë me verërat:

a) “Emërtim origjinë” quhet emri i një rajoni, i një vendi specifik ose, në raste të veçanta të justifikuar në mënyrën e duhur, emri i një shteti, që përdoret për të treguar një produkt që përmbush kriteret e mëposhtme:

i) cilësitë ose karakteristikat e produktit vijnë ekskluzivisht ose esencialisht si rezultat i një mjedisi gjeografik të veçantë, që përfshin faktorët natyrorë dhe njerëzorë, të trashëguar nga ky mjedisi;

ii) hardhitë nga të cilat është prodhuar produkti vijnë ekskluzivisht nga ajo zonë gjeografike;

iii) prodhimi realizohet në atë zonë gjeografike;

iv) produkti përftohet nga varietete hardhish që i përkasin llojit Vitisvinifera.

b) “Tregues gjeografik” quhet një tregues që i referohet një rajoni, një vendi specifik ose, në raste të veçanta dhe të justifikuar, në mënyrën e duhur, emri i një shteti, që përdoret për të treguar një produkt që përmbush kriteret e mëposhtme:

i) zotëron një cilësi, reputacion ose karakteristika të tjera specifike që i atribuohen asaj zone gjeografike;

ii) të paktën 85 për qind e rrushit të përdorur

për prodhim vjen ekskluzivisht nga ajo zonë gjeografike;

iii) prodhimi i tij realizohet në atë zonë gjeografike;

iv) produkti përftohet nga varietete hardhish që i përkasin llojit Vitisvinifera ose një kryqëzim midis llojit Vitisvinifera dhe llojeve të tjera të gjinisë Vitis.

Neni 177

E drejta për të depozituar një aplikim

1. “Grup” quhet çdo shoqatë, pavarësisht nga forma e saj ligjore, i përbërë kryesisht nga prodhuesit apo përpunuesit që punojnë me të njëjtën produkt.

2. Kërkesat për regjistrimin e emrave, si EOM, TGJM, mund të paraqiten vetëm nga grupet të cilat punojnë me produktet, emrat e të cilave do të regjistrohen.

3. Një person i vetëm fizik ose juridik mund të trajtohet si një grup kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

a) personi është i vetmi prodhues i gatshëm të paraqesë një kërkesë;

b) për sa u përket emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve gjeografikë të mbrojtur, zona e përcaktuar gjeografike ka karakteristika, të cilat ndryshojnë dukshëm nga ato të zonave fqinje ose karakteristikat e produktit janë të ndryshme nga ato të prodhuara në zonat fqinje.

4. Grupet e huaja të prodhuesve mund të depozitojnë aplikim, me kusht që e drejta mbi TGM ose EOM është dhënë në vendet e origjinës dhe nëse ato plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

Neni 178

Të drejtat që burojnë nga regjistrimi

1. E drejta e pronësisë mbi TGJ ose EO fitohet nëpërmjet regjistrimit në DPPI. Regjistrimi i një treguesi gjeografik u jep pronarëve të drejtën për ta përdorur atë. Ata nuk kanë të drejtë të japin licenca përdorimi për TGJ ose EO.

2. Pronarët kanë të drejtë të ndalojnë:

a) çdo përdorim tregtar të një TGJ ose EO për mallrat që janë të njëjta ose të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar TGJ ose EO ose çdo përdorim për mallrat, edhe kur ato nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar TGJ ose EO, nëse nga reputacioni i mallrave, për të cilat është regjistruar TGJ ose EO, është arritur përfitim i padrejtë;



b) çdo përdorim të papërshtatshëm ose falsifikim të TGJ ose EO, edhe nëse është specifikuar origjina e vërtetë e mallrave ose çdo përdorim i përkthimit ose përdorim i shoqëruar me terma të tillë si “lloj”, “tip”, “stil” ose të tjera të ngjashme me to;

c) çdo përdorim tjetër i pasaktë dhe i pavërtetë i TGJ ose EO, i origjinës, natyrës ose cilësive thelbësore të mallrave të specifikuara në ambalazhim, në materialet e reklamimit dhe të korrespondencës për produktet, kur të dhëna të tilla shkaktojnë keqinformim për origjinën e vërtetë të produkteve;

ç) çdo përdorim të TGJ ose EO, që identifikon verëra ose pije, që nuk e kanë origjinën në vendin e përcaktuar nga treguesi gjeografik, edhe në rastet kur jepet origjina e vërtetë e tyre ose çdo përdorim i përkthimit apo përdorim i shoqëruar me terma të tilla, si “lloj”, “tip” etj.;

d) çdo veprim tjetër, që mund të shkaktojë keqinformim të përdoruesit për origjinën e vërtetë të mallrave.

3. TGJ ose EO nuk kthehen në emra të zakonshëm për aq kohë sa ato gëzojnë mbrojtje, sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Një TGJ ose EO i regjistruar është një e drejtë kolektive dhe mund të përdoret si e tillë në treg vetëm nga ata që, në përputhje me përcaktimet e nenit 176 dhe kërkesat e nenit 182 prodhojnë, përpunojnë ose përgatitin produktin.

5. Në lidhje me EOM dhe TGJM, verifikimi i përputhshmërisë me specifikimet e produktit përpara hedhjes së tij në treg do të bëhet nga:

a) autoriteti kompetent, i caktuar nga ministri përgjegjës për bujqësinë; ose

b) një ose disa nga organet e kontrollit, të miratuara nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

Neni 179

E drejta e përdoruesit

1. E drejta për të përdorur TGJM ose EOM nuk mund të transferohet ose të lihet peng me një marrëveshje.

2. Nëse TGJM ose EOM përkon me elementin fjalë të markës tregtare të aplikuar ose të regjistruar më parë, marka tregtare në fjalë nuk mund të tranferohet, të licencohet ose të lihet peng me një marrëveshje.

3. Çdo produkt me prejardhje nga Shqipëria që tregtohet në bazë të TGJM ose EOM, në përputhje

me këtë ligj, duhet të etiketohet me shprehjen “tregues gjeografik i mbrojtur” ose “emërtim origjine i mbrojtur” apo me logon e TGJM ose EOM.

4. Çdo produkt me prejardhje jashtë Shqipërisë, që tregtohet në bazë të treguesit gjeografik ose emërtimit të origjinës, të regjistruar, në përputhje me këtë ligj, duhet të etiketohet me shprehjen “tregues gjeografik i mbrojtur” ose “emërtim origjine i mbrojtur” apo me logon e TGJM ose EOM.

5. DPPI-ja përcakton në rregullore logon e EOM, TGJM.

Neni 180

Bazat për refuzimin e regjistrimit

Një emër nuk regjistrohet si TGJ ose EO nëse:

a) është kthyer në emër të zakonshëm në treg në Republikën e Shqipërisë, për një produkt të veçantë, pavarësisht nëse produkti e ka origjinën në vendin e përcaktuar nga TGJ ose EO në fjalë;

b) ka të njëjtin emër me atë të një produkti bujqësor ose të një varieteti shtazor të regjistruar më parë, gjë që shkakton keqinformim te përdoruesit për origjinën e vërtetë të mallrave;

c) është i njëjtë me atë të një treguesi gjeografik ose të një marke të regjistruar më parë, për të njëjtat produkte;

ç) është i njëjtë me atë të një treguesi gjeografik ose të një marke të regjistruar më parë, për produkte që janë të ngjashme ose të njëjta, gjë që shkakton keqinformim te përdoruesit;

d) orienton në mënyrë mashtruese konsumatorin të besojë se produkti vjen nga një territor tjetër;

dh) ka pushuar së përdoruri në një territor gjeografik të caktuar;

e) për personat e huaj kur nuk është i mbrojtur në vendin e origjinës.

Neni 180/a

Homonimet e treguesve gjeografikë ose emërtimeve të origjinës

Nëse emrat e dy ose më shumë vendeve të origjinës së produkteve janë identike apo pothuajse identike, mbrojtja e emrave të tillë si tregues gjeografik ose emërtime origjine do të miratohet për të gjithë prodhuesit që plotësojnë kërkesat e këtij ligji, nëse këto emra janë përdorur në përputhje me praktikat e mira të biznesit dhe informimin e vërtetë të konsumatorit, përveç nëse



ata mund të çorientojnë publikun lidhur me origjinën gjeografike.

Përdoruesi i homonimeve do të sigurojë informata të mjaftueshme mbi etiketën e materialeve të paketimit, në lidhje me origjinën e vërtetë të produktit, në mënyrë që të dallohet një homonim nga një tjetër dhe të mos çorientohet konsumatori.

Neni 180/b

Mbrojtja ndërkombëtare

1. Treguesit gjeografikë ose emërtimet e origjinës së mbrojtur në Republikën e Shqipërisë mund të mbrohen edhe jashtë vendit në bazë të marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen e ndërsjellë ose marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Aplikimet për mbrojtje jashtë vendit mund të paraqiten vetëm nga grupe prodhuesish të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, të regjistruar në regjistrin përkatës të DPPI-së.

3. Aplikimet për mbrojtje si tregues gjeografik apo emërtim origjine në territorin e BE-së mund të paraqiten nga DPPI-ja me kërkesën e grupit të prodhuesve, pas regjistrimit të një emri si EOM ose TGJM në territorin e Shqipërisë.

Neni 180/c

Aplikimi nga një grup i huaj prodhuesish

Kur grupi i huaj prodhues paraqet një kërkesë për mbrojtje të një TGJ ose EO, duhet të bashkëngjitë një kopje të certifikatës ose akt tjetër juridik në gjuhën zyrtare të vendit të origjinës, të lëshuar nga autoriteti kompetent në vendin e origjinës, si një dëshmi se TGJ ose EO është i mbrojtur në atë vend, në përputhje me treguesin gjeografik të mbrojtur, në përputhje me legjislacionin kombëtar në vendin e origjinës, si dhe një përktim të certifikuar në gjuhën shqipe.

Neni 181

Kohëzgjatja e mbrojtjes

1. Mbrojtja e TGJ ose EO fillon me regjistrimin në DPPI, me efekt nga data e depozitimit të aplikimit.

2. Mbrojtja ligjore e një TGJ ose EO të regjistruar është e pakufizuar në kohë dhe përfundon kur nuk ekziston më lidhja ndërmjet vetive e karakteristikave të mallrave dhe mjedisit gjeografik.

KREU XXXI

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E NJË TREGUESI GJOGRAFIK OSE EMËRTIMI ORIGJINE

Neni 182

Depozitimi i aplikimit

1. Aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik ose emërtimi origjine depozitohet pranë DPPI-së.

2. Aplikimi bëhet vetëm për një tregues gjeografik ose emërtimi origjine dhe për një lloj produkti.

3. Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e grupit të prodhuesve dhe të autoriteteve ose, nëse disponohet, organin që verifikon përputhshmërinë me dispozitat ligjore që përcaktojnë specifikimet e produktit;

b) specifikimet e produktit që përfshijnë:

i) emrin që do të mbrohet si emërtim origjine ose tregues gjeografik, ashtu si përdoret në tregti ose në gjuhën e zakonshme;

ii) një përshkrim të produktit, përfshirë materialet e lëndës së parë dhe, nëse është e përshtatshme, edhe karakteristikat kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike ose organoleptike të produktit;

iii) përcaktimin e zonës gjeografike;

iv) prova që produkti e ka origjinën nga zona gjeografike e përcaktuar;

v) një përshkrim të metodës së përfutimit të produktit dhe, kur është e përshtatshme, metodat lokale autentike e të pandryshueshme si dhe një informacion lidhur me paketimin, në qoftë se grupi i prodhuesve vendos kështu, dhe jep justifikime të mjaftueshme në lidhje me specifikat e produktit se përse paketimi duhet të bëhet në zonën e caktuar gjeografike për të ruajtur cilësinë, për të siguruar origjinën ose kontrollin, duke mbajtur parasysh lëvizjen e lirë të mallrave dhe ofrimin falas të shërbimeve;

c) detajet që përcaktojnë:

i) lidhjen midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik; ose

ii) kur është e përshtatshme, lidhjen midis një cilësie të caktuar, reputacionit ose karakteristikave të produktit me origjinën gjeografike;

iii) emrin dhe adresën e autoriteteve ose, nëse është e disponueshme, emrin dhe adresën e organit



që verifikon përputhshmërinë me dispozitat ligjore që përcaktojnë specifikimet e produktit;

iv) çdo rregull specifik për etiketimin e produktit në fjalë;

ç) një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë;

d) autorizimin nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar;

dh) aplikimi shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse.

4. Specifikimet e produktit në lidhje me verën duhet të paktën të përbëhen nga:

a) emri që do të mbrohet;

b) një përshkrim i verës ose verërave;

i) në lidhje emërtimet e origjinës, karakteristikat kryesore analitike dhe organoleptike;

ii) në lidhje me treguesit gjeografikë, karakteristikat kryesore analitike, si dhe një vlerësim ose indikacione të karakteristikave të tij organoleptike;

c) kur është e aplikueshme, praktikat enologjike specifike të përdorura për prodhimin e verës ose verërave, si dhe kufizimet që lidhen me përgatitjen e tyre;

ç) kufijtë e zonës gjeografike që i përkasin;

d) maksimumin e prodhimit për hektar;

dh) një tregues për varietetin ose varietetet e rrushit, nga i cili përftohet vera ose verërat;

e) detajet që rezultojnë nga nënndarja “i”, e shkronjës “a”, të pikës 7, të nenit 176, ose nënndarja “j”, e shkronjës “b”, të pikës 7, të nenit 176;

ë) emrin dhe adresën e autoriteteve ose emrin dhe adresën e organit që verifikon përputhshmërinë me dispozitat ligjore që përcaktojnë specifikimet e produktit.

5. Procedurat dhe plotësimet e tjera për kërkesën përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Neni 182/a

Ekzaminimi i formaliteteve

1. DPPI-ja ekzaminon kërkesat për regjistrimin e treguesve gjeografikë ose emërtimeve të origjinës, sipas numrit rendor të paraqitjes së tyre.

2. DPPI-ja, brenda tre muajve nga data e marrjes së aplikimit, ekzaminon nëse aplikimi

përmban elementet e specifikuara në nenin 182 të këtij ligji.

3. Nëse kërkesa për regjistrimin e treguesit gjeografik apo emërtimit të origjinës i përmban të gjitha elementet e nenit 182 të ligjit, DPPI-ja e publikon atë në buletin e radhës.

4. Nëse DPPI-ja vëren se nuk janë përfshirë të gjitha elementet e nenit 182 të këtij ligji dhe të rregullores së dalë në zbatim të tij, njofton aplikantin për të bërë plotësimet brenda dy muajve nga data e njoftimit. Kur aplikanti nuk kryen plotësimet e kërkuara brenda kohës së caktuar, DPPI-ja refuzon aplikimin për regjistrimin e treguesit gjeografikë apo emërtimit të origjinës.

5. Periudha për paraqitjen e plotësimeve mund të zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikanti paraqet një kërkesë me shkrim për zgjatje afati, të shoqëruar me pagesën përkatëse, e cila duhet të depozitohet brenda përfundimit të afatit dymujor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.

6. Vendimi për refuzimin e aplikimit mund të apelohe brenda 1 muaji në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim.

Neni 182/b

Publikimi i aplikimit

1. DPPI-ja publikon elementet kryesore të aplikimit.

2. Të dhënat që publikohen në buletin e DPPI-së përcaktohen në rregulloren përkatëse.

Neni 182/c

Ekzaminimi në substancë

1. Në qoftë se aplikimi për një TGJ ose EO i referohet një produkti bujqësor apo ushqimor, brenda 30 ditëve nga data e mbylljes së publikimit, DPPI-ja i dërgon kërkesën, me një kopje të dosjes, ministrit përgjegjës për bujqësinë për vlerësim, në lidhje me specifikimet e produktit, në përputhje me kërkesat e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 182, dhe nenit 176, të këtij ligji.

2. Në qoftë se aplikimi për një TGJ ose EO i referohet një produkti jobujqësor apo joushqimor, brenda një muaji nga data e mbylljes së publikimit, DPPI-ja i dërgon kërkesën me një kopje të dosjes së aplikimit autoritetit kompetent për vlerësim në lidhje me specifikimet e produktit, në përputhje me kërkesat e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 182 dhe nenit 176, të këtij ligji.



3. Procedura në lidhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përcaktohet në rregulloren përkatëse.

4. Vlerësimi i kërkuar sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohet nga organet kompetente brenda një periudhe dymujore nga data e paraqitjes së kërkesës.

5. Kur vlerësimi i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, është pozitiv, DPPI-ja regjistron treguesin dhe lëshon certifikatën.

6. Kur vlerësimi, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, është negativ, DPPI-ja refuzon regjistrimin e aplikimit dhe njofton aplikantin.

7. Vendimi i refuzimit, i lëshuar sipas pikës 6, të këtij neni, mund të apelohej në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 182/ç

Procedura e kundërshtimit

1. Çdo person fizik ose juridik që ka interes të ligjshëm mund të depozitojë një kundërshtim ndaj aplikimit brenda një afati tremujor nga data e publikimit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, pranë Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.

2. Kundërshtimi duhet të përfshijë:

a) emrin dhe adresën e personit që depoziton kundërshtimin;

b) të dhëna që justifikojnë interesin ekonomik ose juridik të personit që depoziton kundërshtimin.

Të dhënat për depozitimin e kundërshtimit dhe procedurat përkatëse përcaktohen në rregulloren përkatëse.

3. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve ekzaminon nëse kundërshtimi është depozituar në përputhje me kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Nëse kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk plotësohen, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton paraqitësin e kërkesës.

5. Nëse kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, plotësohen, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve njofton aplikantin dhe i jep atij mundësinë të paraqesë vërejtje, shpjegime ose dokumente shtesë brenda dy muajve nga data e njoftimit.

6. Afati kohor, i parashikuar në pikën 5, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.

7. Nëse kundërshtimi ka si objekt specifikimet e një produkti bujqësor ose ushqimor, bazuar në

shkronjën “a”, të nenit 182/d, të këtij ligji, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon dosjen e aplikimit së bashku me dosjen e plotë për kundërshtim ministrit përgjegjës për bujqësinë për miratim brenda një muaji nga plotësimi i të gjitha dokumenteve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

8. Nëse kundërshtimi ka si objekt specifikimet e një produkti jobujqësor ose joushqimor, bazuar në shkronjën “a”, të nenit 182/d, të këtij ligji, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon dosjen e aplikimit së bashku me dosjen e plotë për kundërshtim autoritetit kompetent për miratim brenda 1 muaji nga plotësimi i të gjitha dokumenteve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

9. Nëse kundërshtimi ka si objekt një pretendim të bazuar në shkronjat “b”, “c”, dhe “d”, të nenit 182/d, të këtij ligji, kërkesa shqyrtohet nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, që del me vendim brenda 2 muajve nga plotësimi i të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në rregulloren përkatëse. Vendimi, sipas kësaj pike, mund të apelohej në Bordin e Apelit brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit.

10. Nëse aplikanti i TGJ ose EO së kundërshtuar paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve shqyrton brenda dy muajve argumentet dhe bazën ligjore, mbi të cilat mbështetet kundërshtimi.

11. Bazuar në një vlerësim pozitiv në lidhje me aplikimin e kundërshtuar, referuar pikave 7 dhe 8, të këtij neni, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve brenda një muaji merr vendim për lëshimin e certifikatës, duke konfirmuar regjistrimin, pas kryerjes së pagesës së tarifës përkatëse.

12. Bazuar në një vlerësim negativ në lidhje me aplikimin e kundërshtuar, referuar pikave 7 dhe 8, të këtij neni, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve brenda një muaji merr vendim për refuzimin e regjistrimit dhe njofton aplikantin.

13. Kundër vendimit të refuzimit, të parashikuar në pikën 12, të këtij neni, mund të bëhet apelim në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit.



Neni 182/d

Bazat për kundërshtim

1. Një kundërshtim ndaj një aplikimi për regjistrimin e një TGJ ose një EO do të jetë i pranueshëm vetëm nëse ai do të depozitohet në DPPI brenda afatit tremujor të publikimit dhe nëse:

a) tregon se aplikimi për regjistrimin e TGJ ose EO nuk përmbush kushtet e parashikuara në nenin 176 dhe shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 182;

b) tregon se regjistrimi i emrit që kërkohet të mbrohet është në kundërshtim me nenin 180;

c) tregon se regjistrimi i emrit që kërkohet të mbrohet rrezikon një emër tërësisht ose pjesërisht identik të mbrojtur ose një markë tregtare që gëzon të drejta të mëparshme ose ekzistencën e produkteve, të cilat kanë qenë ligjrisht në treg për të paktën pesë vjet para datës së regjistrimit; ose

ç) jep detaje, nga të cilat mund të konkludohet se emri për të cilin kërkohet regjistrimi është një term i përgjithshëm përshkrues.

2. Afati sipas pikës 1, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.

Neni 182/dh

Ndryshime në specifikimet e produktit

1. Një grup që ka interes të ligjshëm mund të aplikojë për miratimin e ndryshimeve në specifikimet e produktit.

2. Aplikanti duhet të justifikojë dhe të japë arsye në lidhje me ndryshimet e kërkuara.

3. Aplikimi për ndryshim do të ndjekë procedurën e parashikuar në nenet 182, 182/a, 182/b, 182/c, 182/ç dhe 182/d të këtij ligji.

Neni 183

Shfuqizimi i një treguesi gjeografik

1. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim, me kërkesë të çdo pale që ka një interes të ligjshëm, mund të marrë vendim për shfuqizimin e një TGJM ose EOM në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk ekziston më përputhshmëria me kushtet e specifikimeve të produktit;

b) kur nuk është hedhur në treg asnjë produkt me këtë TGJM ose EOM për një periudhë kohore të pandërprerë prej shtatë vjetësh.

2. Rregulla të hollësishme në lidhje me procedurën e shfuqizimit përcaktohen në rregulloren përkatëse.

3. Vendimi i shfuqizimit të TGJM ose EOM

apelohet në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit mbi vendimin.”.

Neni 39

Në nenin 184, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimet e kryera nga çdo person, në kundërshtim me nenet 36, 37, pika 1, 47 e 48, të ligjit, për një shpikje, e cila mbrohet nga një patentë ose nga një aplikim për patentë, përbëjnë shkelje të të drejtave të patentës.

Në gjykimet civile për shkeljet e të drejtave të një procesi të patentuar, kur objekti i një patente është një proces për përfitim të një produkti, gjykata ka të drejtë të urdhërojë të paditurin të provojë se procesi për përfitim të një produkti identik është i ndryshëm nga procesi i patentuar.

Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e mëparshëm, nëse:

a) produkti i përfutur nga procesi është i ri;

b) ose ka gjasa thelbësore se produkti të jetë bërë nga procesi i patentuar, por pronari i patentës nuk ka qenë në gjendje pas përpjekjesh të arsyeshme të përcaktojë procesin e përdorur faktikisht, do të prezumohet se produkti është prodhuar duke përdorur procesin e patentuar, përveç kur provohet e kundërta.”.

Neni 40

Në nenin 184/b, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) ndalimin e mallrave/shërbimeve që shkelin të drejtat e personave që parashikohen në nenin 184/a;

b) heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil i materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e mallrave ose shërbimeve që shkelin të drejtat;

c) në lidhje me mallrat e paligjshme (*counterfeiting*), thjesht heqja ose shpikëputja e markës së ngjitur në këto mallra nuk është e mjaftueshme, përveçse në raste përjashtimore për të lejuar hedhjen në treg të këtyre mallrave.”.

Neni 41

Pas nenit 184/c shtohet neni 184/ç me këtë përmbajtje:



“Neni 184/ç

Paditë kundër vendimeve të Bordit të Apelit

Kundër një vendimi të Bordit të Apelit mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 45 ditëve nga dita kur është marrë njoftim për vendimin.”.

Neni 42

Pas nenit 185 shtohet neni 185/a me këtë përmbajtje:

“Neni 185/a

Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale, për qëllim të zbatimit të këtij ligji, duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

Neni 43

Titulli dhe kreu XXXIII ndryshohen si më poshtë:

“KREU XXXIII

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI
I DPPI-SË

Neni 189

**Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë
Industriale (DPPI)**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucion publik jobuxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka selinë e vet në Tiranë.

2. Drejtori i Përgjithshëm e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

3. Veprimtaria e DPPI-së përcaktohet dhe rregullohet me këtë ligj dhe me akte të tjera të nënligjore.

4. Marrëdhëniet e punës të nëpunësve të DPPI-së rregullohen nga ligji për nëpunësin civil.

5. DPPI-ja ka logon dhe vulën e saj të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 189/a

**Organet drejtuese të Drejtorisë së
Përgjithshme të Pronësisë Industriale**

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 189/b

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës është organ kolegjal, i përbërë nga 5 anëtarë, kryetari dhe 4 anëtarë, nga të cilët:

a) një jurist;

b) një financier;

c) një anëtar i kabinetit të Kryeministrit;

ç) një anëtar i kabinetit të ministrit përgjegjës për ekonominë;

d) një anëtar nga struktura që mbulon investimet e huaja.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë.

3. Kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët që parashikohen në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Në rast se kjo shumicë nuk arrihet, kryetari emërohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 189/c

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli i Mbikëqyrës ka këto kompetenca:

1. Mbikëqyr veprimtarinë e DPPI-së dhe ushtron çdo kompetencë tjetër sipas këtij ligji.

2. Miraton programet e zhvillimit të DPPI-së.

3. Miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe të funksionimit të DPPI-së.

4. Miraton strukturën dhe organikën e DPPI-së me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm pas marrjes së dakordësisë nga ministri përgjegjës për administratën publike dhe ministri përgjegjës për financat.

5. Miraton programin financiar të DPPI-së si dhe projektbuxhetin, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave.

6. Miraton projektin për nivelin e pagave të punonjësve të DPPI-së, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave.

7. Miraton çdo vit kriteret dhe masat për shpërblimet stimuluuese të personelit për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

8. Miraton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.



Neni 189/ç

Kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Personi, që është për t'u emëruar si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 189/b, duhet të plotësojë këto kërkesa:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”;
- c) të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion, në administratën publike, në institucione qendrore publike;
- ç) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë veprë penale;
- d) të mos jetë larguar nga shërbimi civil;
- dh) të mos ketë vërejtje të pashuara ende;
- e) të mos ketë konflikte interesash me detyrën, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 189/d

Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 vjet, pa të drejtë riemërimi, përveç rasteve kur anëtarët e zgjedhur sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 189/b, lirohen nga funksionet e tyre përpara mbarimit të mandatit, të cilët do të zëvendësohen sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj për mandatin e mbetur. Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës, që parashikohen në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 189/b, vazhdojnë të jenë anëtarë për aq kohë sa zgjat mandati i tyre, sipas këtij neni.

2. Kur mandati i kryetarit apo i një anëtari përfundon, ai qëndron në detyrë deri kur zëvendësohet. Një muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Këshillit Mbikëqyrës, DPPI-ja lajmëron me shkrim ministrin përgjegjës për ekonominë, i cili fillon procedurat për emërimin e anëtarit të ri.

3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në detyra të tjera, por nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë këshilli tjetër mbikëqyrës.

Neni 189/dh

Largimi nga detyra i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës

1. Largimi nga detyra i anëtarit të Këshillit

Mbikëqyrës përpara përfundimit të mandatit bëhet kur anëtari:

- a) jep dorëheqjen;
- b) humbet pozicionin, sipas shkronjave “c” , “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 189/b;
- c) bëhet fizikisht i paaftë për më shumë se tre muaj të përbushë detyrën, për të cilën është emëruar;
- ç) mungon pa arsye për më shumë se tre mbledhje radhazi;
- d) i shkakton dëm DPPI-së apo imazhit të saj për shkak të paaftësisë profesionale ose të qëndrimeve neglizhente;
- dh) duke qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, ai/a jo vepron në kundërshtim me interesat e DPPI-së;
- e) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- ë) humbet apo lë shtetësinë shqiptare.

2. Propozimi për lirim nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës bëhet nga vetë këshilli ose nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, shoqëruar me arsyet dhe dokumentet provuese, në bazë të të cilave kërkohet ky lirim. Ky propozim i paraqitet ministrit përgjegjës për ekonominë, i cili fillon procedurat përkatëse për lirim nga detyra.

3. Ministri, në zbatim të pikës 2, të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga kryerja e funksioneve deri në përfundim të verifikimit dhe marrjes së një vendimi.

4. Kur një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës lirohet nga detyra përpara mbarimit të mandatit, anëtari i ri zëvendësues emërohet sipas së njëjtës procedurë që u ndoq për emërimin e anëtarit që u largua.

Neni 189/e

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren nga kryetari, me kërkesën e secilit prej anëtarëve ose me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI-së. Drejtori i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e këtij këshilli pa të drejtë vote.

2. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet të paktën katër herë në vit. Mbledhjet e këshillit drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve, i autorizuar prej tij.

3. Këshilli Mbikëqyrës harton rregulloren e tij të brendshme për funksionimin dhe organizimin e



Këshillit Mbikëqyrës. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së ia paraqet këtë rregullore për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë.

4. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë të tij. Vendimet e tij janë të vlefshme kur shumica e anëtarëve të pranishëm votojnë në favor të tyre. Abstenimi nuk lejohet.

5. Për çdo mbledhje mbahet procesverbali nga sekretari teknik, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, përfshi edhe sekretarin teknik, ndërsa vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nënshkruhen nga kryetari.

6. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së cakton një punonjës të DPPI-së në rolin e sekretarit teknik të Këshillit Mbikëqyrës.

7. Kryetari, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretari teknik shpërblehen në masën dhe sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 190

Detyrimet, kufizimet dhe e drejta e shpërblimeve stimuluese të punonjësve të DPPI-së

1. Punonjësit e DPPI-së, gjatë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë, si dhe për një periudhë kohore prej një viti, pas përfundimit të punës në këtë drejtori, nuk mund të depozitojnë aplikime për patenta, marka tregtare, diseno industriale ose tregues gjeografikë. Atyre nuk u lejohet të gëzojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të drejta mbi patentat, markat tregtare ose disenjat industriale, përveç rasteve të trashëgimisë, të miratuara nga DPPI-ja, dhe as nuk mund të përfitojnë ndonjë të drejtë që rrjedh prej tyre.

2. Punonjësit e DPPI-së nuk mund të gëzojnë asnjë të drejtë për prioritet për patentat, regjistrimet e markave, disenjoje industriale ose të treguesve gjeografikë ose për aplikimet për patenta, marka, diseno industriale ose tregues gjeografikë, të cilat kanë datë më të hershme se një vit nga përfundimi i punës në këtë drejtori.

3. Punonjësit e DPPI-së kanë të drejtën të marrin shpërblime stimuluese për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 191

Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së

1. Drejtori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e kësaj drejtorie dhe ndjek përmbushjen e dispozitave, të parashikuara në këtë ligj dhe në rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.

2. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dy apo shumëpalëshe me zyra homologe në fushën e pronësisë industriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson drejtorinë për çështje të pronësisë industriale në gjykatë, arbitrazh dhe institucionet shtetërore, brenda hapësirave të parashikuara në legjislacionin në fuqi, si dhe përfaqëson vendin për çështje të pronësisë industriale në organizatat ndërkombëtare të fushës, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

4. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Drejtori i Përgjithshëm i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyrës rregulloren e brendshme të kësaj drejtorie, si dhe nxjerr urdhra, udhëzime ose akte të tjera të brendshme.

5. Drejtori i Përgjithshëm menaxhon punonjësit administrativë, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

6. Drejtori i Përgjithshëm i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyrës organikën, strukturën, projektin e nivelit të pagave, si dhe shpërblimet e punonjësve të DPPI-së.

7. Drejtori i Përgjithshëm i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyrës kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, pas marrjes së dakordësisë nga ministri përgjegjës për shoqërinë e informacionit.

Neni 191/a

Të ardhurat e DPPI-së

1. Të ardhurat që realizon DPPI-ja janë:

- a) të ardhurat që krijohen nga aktiviteti i saj;
- b) të ardhurat nga tarifat e Sistemit të Madridit për regjistrimin e markave ndërkombëtare, e Marrëveshjes së Hagës për aplikimet ndërkombëtare për diseno industriale, si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera që Republika e Shqipërisë ka lidhur ose do të lidhë në fushën e pronësisë industriale;
- c) të ardhura të tjera që mund të krijohen sipas legjislacionit në fuqi.



2. Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, aktivitete të ndryshme në fushën e pronësisë industriale, brenda dhe jashtë vendit, të gjitha këto të nevojshme për ushtrimin dhe realizimin e funksioneve të DPPI-së, si dhe kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të PI-së.

4. Për projektet, aktivitetet apo investimet që zbatohen në kuadër të marrëveshjeve të lidhura nga DPPI-ja me institucione ndërkombëtare të fushës, të cilat investohen tërësisht me fondet e tyre apo pjesërisht edhe me fondet e DPPI-së, zbatohen procedurat që ndjekin këto institucione ose procedurat që përcaktohen në marrëveshjet përkatëse të lidhura me këto institucione.

Neni 191/b

Buxheti

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.

2. Veprimtaria e DPPI-së financohet nga të ardhura të knjuara nga kryerja e veprimtarisë së saj në zbatim të këtij ligji dhe nga burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat që DPPI-ja realizon, sipas këtij ligji, por të pashpërndara në fund të vitit, derdhen në Buxhetin e Shtetit, me përjashtim të:

- a) fondeve të parashikuara për investime;
- b) pagesave të menjëhershme për llogari të institucioneve ndërkombëtare të fushës, sipas të cilave Republika e Shqipërisë ka detyrime financiare.

3. DPPI-ja ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet të administrojë asetet e llogaritë e saj bankare pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 191/c

Kontabiliteti

1. DPPI-ja mban regjistrat kontabël, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kontabël të zbatueshme.

2. Regjistrat kontabël duhet të pasqyrojnë me saktësi, në çdo kohë, gjendjen financiare të DPPI-së.

3. DPPI-ja përgatit pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe, pas verifikimit dhe certifikimit të

tyre nga ekspertët auditues, i raporton për rezultatin financiar ministrit përgjegjës për ekonominë.

Neni 191/ç

Raportimi nga DPPI-ja

1. Në muajin prill të vitit pasardhës DPPI-ja i paraqet ministrit:

a) një raport vjetor për veprimtarinë e tij, përfshirë të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës:

- b) pasqyrën vjetore financiare;
- c) një raport për realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve.

2. DPPI-ja i paraqet ministrit përgjegjës për ekonominë, me kërkesë të këtij të fundit, çdo të dhënë tjetër që vlerësohet e nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të DPPI-së.

Neni 192

Regjistrat dhe buletini

1. DPPI-ja mban dhe administron regjistrat për:

a) aplikimet për regjistrimin e markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe aplikimet për patentat e shpikjeve, modeleve të përdorimit dhe regjistrimin e topografisë së produkteve gjysmëpërçuese;

b) patentat e shpikjeve, modelet e përdorimit, topografia e produkteve gjysmëpërçuese, markat, disenjot industriale, treguesit gjeografikë, të regjistruara në DPPI;

c) përfaqësuesit e autorizuar për patentat, markat, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë;

ç) ekspertët e PI-së të licencuar nga DPPI-ja sipas nenit 198/b.

2. Regjistrat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, janë të hapur për inspektime nga publiku.

3. Të gjitha ndryshimet në lidhje me të dhënat e objekteve të pronësisë industriale pasqyrohen në regjistër dhe publikohen në Buletinin e Pronësisë Industriale.

4. DPPI-ja publikon Buletinin e Pronësisë Industriale të paktën një herë në muaj, në përputhje me kërkesat e këtij ligji. DPPI-ja e mban Buletinin e Pronësisë Industriale në format elektronik dhe e boton atë në faqen zyrtare të internetit.



Neni 192/a

Transmetimi i të dhënave elektronike

Për të lehtësuar procedurat e regjistrimit dhe/ose ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë, në favor të subjekteve të interesuara, DPPI-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bashkëpunon me autoritete të tjera publike, brenda dhe jashtë vendit, për ndërlidhjen dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave.

Neni 192/b

Veprimet pranë modulit për aplikimin elektronik

1. Çdo individ, pasi të jetë identifikuar elektronikisht, ka të drejtë që, në cilësinë e aplikantit apo të personit të autorizuar, të aplikojë apo të kryejë pranë sportelit elektronik çdo kërkesë për regjistrim apo veprim tjetër, sipas këtij ligji, përfshirë këtu procedurat e ankimit administrativ, dhe të marrë nga DPPI-ja nëpërmjet këtij moduli konfirmimin e marrjes nga DPPI-ja të aplikimit të tyre. Çdo aplikim/kërkesë në format elektronik duhet të shoqërohet me nënshkrimin elektronik, sipas legjislacionit në fuqi, për t'i dhënë vlerë ligjore këtij dokumenti.

2. Çdo individ, pa qenë i detyruar të identifikohet elektronikisht, ka të drejtë të kryejë pranë modulit për aplikimin elektronik kërkime elektronike në regjistër, të marrë ekstrakte, si dhe kopje të dokumenteve shoqëruese në format elektronik apo të kryejë veprime të tjera për informacione, të cilat janë të hapura për publikun dhe për të cilat identifikimi i personit, kryerja e pagesës së një tarife nëpërmjet mjeteve elektronike nuk kërkohet, sipas këtij ligji.

Neni 192/c

Identifikimi elektronik

Veprimet pranë modulit për aplikimin elektronik të DPPI-së, për të cilat ky ligj kërkon identifikimin elektronik, kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik. Identifikimi elektronik kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

Neni 192/ç

Kushtet procedurale dhe teknike për modulën e aplikimit elektronik

1. Këshilli Mbikëqyrës përcakton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, sipas këtij ligji, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik, kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat për ndryshimin e tyre, kushtet e sigurisë e të ruajtjes së komunikimeve elektronike, mënyrat e vërtetimit të dokumenteve elektronike, të kërkesave e teknologjisë së zbatueshme për realizmin e tyre, sipas këtij ligji, si dhe procedurat e njoftimit publike, të realizuara nga DPPI-ja për rastet e remonteve të planifikuara apo të incidenteve teknike të modulit për aplikimin elektronik, si dhe për njoftimin e rasteve të ndërhyrjeve të paautorizuara.

2. Rregullat e parashikuara në këtë nen do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për ofrimin e shërbimeve publike me mjete elektronike.

Neni 193

Dhoma për shqyrtimin e kundërshtimeve

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve është një strukturë e ngritur brenda njësisë së ekzaminimit dhe merr në shqyrtim observacionet dhe kërkesat për kundërshtim, në kuptim të këtij ligji.

2. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve përbëhet nga tre anëtarë të njësisë së ekzaminimit që emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

3. Vendimet e marra nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të ankimohen në Bordin e Apelit, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda një muaji nga data e marrjes dijeni të vendimit.

4. Organizimi dhe funksionimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve rregullohen me rregulloren e brendshme të DPPI-së.

Neni 193/a

Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim

1. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim është një strukturë e ngritur brenda DPPI-së dhe merr në shqyrtim kërkesat për shfuqizim, zhvlerësim dhe apelimet e vendimeve për refuzim, në kuptim të këtij ligji.



2. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim përbëhet nga tre anëtarë, që emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

3. Një prej anëtarëve të dhomës për shfuqizim/zhvlerësim është jurist.

4. Vendimet e marra nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të ankimohen në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda një muaji nga data e marrjes dijeni të vendimit.

5. Organizimi dhe funksionimi i dhomës për shfuqizim/zhvlerësim rregullohen me rregulloren e brendshme të DPPI-së.

Neni 193/b

Bordi i Apelit

1. Bordi i Apelit përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët tre janë punonjës të DPPI-së dhe dy anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së, të cilët plotësojnë kushtet për ekspertë të PI-së. Anëtarët e Bordit të Apelit nuk mund të jenë përfaqësues të autorizuar.

2. Anëtarët e dhomës për shfuqizim/zhvlerësim nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Apelit.

3. Kryetari i Bordit të Apelit është Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së. Anëtarët e Bordit të Apelit emërohen dhe lirohen nga Këshilli Mbikëqyrës, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI-së për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë riemërimi.

4. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së cakton një punonjës të DPPI-së në rolin e sekretarit teknik të Bordit të Apelit.

5. Organizimi, funksionimi i Bordit të Apelit, si dhe shpërblimi i kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit të Bordit të Apelit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave për Bordin e Apelit.

6. Bordi i Apelit mbledhet sa herë është e nevojshme, por jo më pak se 4 herë në vit.

7. Procedurat e hollësishme për emërimin dhe lirimimin e anëtarëve të Bordit të Apelit parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për Bordin e Apelit.

Neni 193/c

Lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit të Apelit

Anëtari i Bordit të Apelit mund të lirohet nga detyra në rast se:

a) nuk përmbush detyrat e caktuara;

b) i është ndaluar ushtrimi i këtij aktiviteti me vendimi gjyqësor të formës së prerë;

Faqe | 2812

c) ka paraqitur dorëheqjen.

Neni 193/ç

Komisioni i Vlerësimit

1. Komisioni i Vlerësimit është një strukturë e ngritur brenda DPPI-së për licencimin e përfaqësuesve të autorizuar, si dhe ekspertëve të PI-së, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë, që emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

3. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Vlerësimit rregullohen me vendimin e Këshillit të Ministrave për përfaqësuesit e autorizuar dhe ekspertët.

Neni 193/d

Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale

1. Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së DPPI-së, organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare në fushën e PI-së.

2. Procedurat dhe tarifatat përkatëse për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 194

Informimi i publikut

1. Informimi i publikut për dokumente dhe informacione të tjera, që gjenden në DPPI, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit dhe sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dokumentet dhe informacioni, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, jepen kundrejt tarifave të përcaktuara.”

Neni 44

Neni 197 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 197

Përfaqësuesit e autorizuar të patentave dhe markave

1. Përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit mund të jetë:

1.1. Çdo person me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë me kusht që:



a) të ketë përfunduar së paku studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave”:

i) në fushën e inxhinierisë ose të shkencave natyrore ose farmaceutike, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;

ii) në një fushë tjetër dhe të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në këtë fushë, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;

b) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e përfaqësuesve të autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.

1.2. Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar, që ka jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale në DPPI.

2. Përfaqësues i autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë mund të jetë:

2.1. Çdo person me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, me kusht që:

a) të ketë kryer së paku studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;

b) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve në fushën e markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë.

2.2. Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar, që ka jo më pak se 3 vjet përvojë pune në çështjet e pronësisë industriale pranë DPPI-së.

3. DPPI-ja është organi i vetëm që licencën dhe vlerëson përfaqësuesit e autorizuar për objektet e pronësisë industriale, nëpërmjet testimit me shkrim.”.

Neni 45

Neni 198 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 198

Testimi kualifikues dhe Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar

1. Komisioni i Vlerësimit organizon testimin për kualifikimin e përfaqësuesve të autorizuar pranë DPPI-së. Pjesëmarrja në këtë testim bëhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. DPPI-ja regjistron në regjistrin përkatës përfaqësuesit e autorizuar të patentave, disenjove industriale, markave dhe treguesve gjeografikë, si dhe i publikon në format elektronik në faqen zyrtare të saj.

3. DPPI-ja i publikon përfaqësuesit e autorizuar të patentave, disenjove industriale, markave dhe treguesve gjeografikë, në format elektronik në faqen zyrtare të saj vetëm pasi ata kanë dorëzuar në DPPI ekstraktin e regjistrimit për lejin e ushtrimit të aktivitetit tregtar.

4. Nëse përfaqësuesi nuk e ushtron aktivitetin tregtar për një periudhë 5-vjeçare, licenca nuk ripërtërihet dhe përfaqësuesi duhet t'i nënshtrohet edhe një herë testimit për marrjen e licencës.

5. Detajet për Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për përfaqësuesit e autorizuar dhe ekspertët.

6. Regjistrimi i përfaqësuesve të autorizuar në regjistrin e përfaqësuesve, çdo ndryshim në këtë regjistër, si dhe publikimi në faqen zyrtare të DPPI-së bëhen kundrejt kërkesës dhe pagesës së tarifave përkatëse.

7. Regjistrimi në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar ripërtërihet çdo vit para datës së mbarimit të këtij afati kundrejt pagesës së tarifës së ripërtëritjes së regjistrimit të përfaqësuesve të autorizuar, të parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave për tarifën.

8. Detajet për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar, si dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për përfaqësuesit e autorizuar dhe ekspertët.”.

Neni 46

Pas nenit 198 shtohen nenet 198/a, 198/b, 198/c, 198/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 198/a

Heqja nga Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar

1. Përfaqësuesi i autorizuar hiqet nga Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar në rast se:

a) nuk bën pagesën e tarifës së ripërtëritjes së regjistrimit në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 198, të këtij ligji;

b) është depozituar një kërkesë për dorëheqje nga regjistri prej vetë atij;



c) me vendim gjyqësor, ai është ndaluar të ushtrojë aktivitetin si përfaqësues i autorizuar;

ç) nuk depoziton në kohë dokumentet, nëse ka të tilla, për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar;

d) përfaqësuesi i autorizuar humb shtetësinë shqiptare.

2. Nëse DPPI-ja konstaton se për një përfaqësues të autorizuar ekziston një prej shkaqeve të mësipërme, sipas pikës 1, të këtij neni, vendos heqjen nga regjistri të përfaqësuesit të autorizuar dhe e publikon këtë në faqen zyrtare të DPPI-së.

3. Nëse konstatohet shkelje e etikës profesionale apo e rregullave morale përgjithësisht të njohura nga përfaqësuesi i autorizuar, Komisioni i Vlerësimit mund të marrë vendim për heqjen e licencës së tij për një periudhë nga dy deri në pesë vjet.

4. Kundër vendimit të marrë, sipas pikës 3, të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit.

Neni 198/b Ekspertët e PI-së

1. Ekspert për Patentat e Shpikjeve dhe Modeleve të Përdorimit mund të jetë:

1.1. Çdo individ me kusht që:

a) të ketë qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” në fushën ku kërkohet ekspertizë;

c) të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit apo të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;

ç) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve të fushës për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.

1.2. Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar në fushën ku kërkohet ekspertizë, që ka jo më pak se 4 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale dhe çdo ish-anëtar i Bordit të Apelit pranë DPPI-së, që ka jo më pak se 2 vjet pune në këtë bord.

2. Ekspert për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë mund të jetë:

2.1. Çdo individ me kusht që:

a) të ketë qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për markat, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë pranë DPPI-së apo të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse të specializuara në fushën e pronësisë industriale;

c) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve në fushën e markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë;

ç) të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”.

2.2. Çdo ish-punonjës i DPPI-së që ka jo më pak se 4 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale, si dhe çdo ish-anëtar i Bordit të Apelit pranë DPPI-së, që ka jo më pak se 2 vjet pune në këtë bord.

3. DPPI-ja është organi i vetëm që licencën dhe vlerëson ekspertët e PI-së nëpërmjet testimit me shkrim.

4. Ekspertët nuk mund të jenë njëkohësisht edhe përfaqësues të autorizuar.

Neni 198/c Testimi vlerësues dhe Regjistri i Ekspertëve

1. Komisioni i Vlerësimit organizon testimin për vlerësimin e ekspertëve të objekteve të pronësisë industriale. Pjesëmarrja në këtë testim bëhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. DPPI-ja regjistron në Regjistrin e Ekspertëve ekspertët e patentave për shpikje, modeleve të përdorimit, markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë, si dhe i publikon në format elektronik në faqen zyrtare.

3. DPPI-ja i publikon ekspertët e PI-së në format elektronik në faqen zyrtare të saj, vetëm pasi ata kanë dorëzuar në DPPI ekstraktin e regjistrimit për lejimin e ushtrimit të aktivitetit tregtar.

4. Nëse eksperti i PI-së nuk e ushtron aktivitetin tregtar për një periudhë 5-vjeçare, licenca nuk ripërtërihet dhe eksperti duhet t'i nënshtrohet edhe një herë testimit për marrjen e licencës.

5. Detajet për Regjistrin e Ekspertëve dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekspertët e PI-së.

6. Regjistrimi i ekspertëve në Regjistrin e Ekspertëve, si dhe çdo ndryshim në regjistër apo publikimi në faqen zyrtare bëhet kundrejt pagesës



së tarifave përkatëse që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për tarifaf.

7. Regjistrimi në Regjistrin e Ekspertëve ripërtërihet çdo vit para datës së skadimit të saj, kundrejt pagesës së tarifës për ripërtëritje të licencës së ekspertëve të parashikuar me vendimin e Këshillit të Ministrave për tarifaf.

8. Hollësitë për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Ekspertëve, si dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekspertët e PI-së.

Neni 198/ç

Heqja e ekspertëve nga regjistri

1. Ekspertët e PI-së hiqen nga Regjistri i Ekspertëve në rast se:

- a) licenca nuk është ripërtëritur për 5 vjet radhazi;
- b) është depozituar një kërkesë për dorëheqje nga regjistri;
- c) ekspertit i ndalohet ushtrimi i këtij aktiviteti me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- ç) si rezultat i një vendimi të Komisionit të Vlerësimit, ai është ndaluar të ushtrorë aktivitetin si ekspert për shkaqet e parashikuara në VKM-në për ekspertët dhe përfaqësuesit e autorizuar.

2. Ripërtëritja e regjistrimit për një ekspert nuk pranohet në rastet:

- a) kur nuk është bërë pagesa e tarifës së ripërtëritjes së regjistrimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 198/c, të këtij ligji;
- b) nëse nuk depoziton në kohë dokumentet që kërkohen për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Ekspertëve.

3. Kur DPPI-ja konstaton se nuk janë përmbushur kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vendos heqjen e ekspertit nga Regjistri i Ekspertëve dhe e publikon atë në faqen zyrtare të DPPI-së.

4. Nëse konstatohet shkelje e etikës profesionale apo moralit nga eksperti i PI-së, Komisionit i Vlerësimit mund të marrë vendim për heqjen e licencës së tij për një periudhe 5-vjeçare.

5. Kundër vendimit të marrë, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 1 muaji nga data e marrjes njoftim të vendimit.”

Neni 47

Dispozita kalimtare

1. Për procedurat e regjistrimit të të drejtave të pronësisë industriale, që nuk kanë përfunduar deri

në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e aplikimit.

2. Për procedurat e shkeljeve të të drejtave të pronësisë industriale, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e fillimit të procedurave.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Drejtori i Përgjithshëm dhe punonjësit e DPPM-së vijojnë të ruajnë pozicionet e tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

4. Shndërrimi i DPPM-së në agjenci autonome me vetëfinancim i fillon efektet financiare brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 48

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës që, brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të marrë masat e nevojshme për ngritjen e Këshillit Mbikëqyrës.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 43 të këtij ligji.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 43, 45 dhe 46 të këtij ligji.

Neni 49

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.2.2017

Shpallur me dekretin nr. 10059, datë 6.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 18/2017

PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësisht të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;

ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin

dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia” nënkupton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

2. “Autoritet përgjegjës” është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, kryen/jnë dhe mbulon/jnë shërbime të specializuara e profesionale për fëmijën.

3. “Dhunë ndaj fëmijës” është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur moshja e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa moshja e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. “Fëmijë i pashoqëruar” është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.

6. “Fëmijë në nevojë për mbrojtje” është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

7. “Këshilli” nënkupton Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

8. “Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

9. “Ndëshkimi trupor” është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë



dhimbje ose shqetësim të fëmija, nga çdo person ligjërishit përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të.

10. “Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

11. “Përmbajtje të dëmshme për fëmijën” janë çdo pamje, imazh dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.

12. “Përfaqësues procedural” është personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.

13. “Pjesëmarrje e fëmijës” është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes aktive të fëmijës dhe i respektimit të së drejtës së tij për t’u shprehur e për t’u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.

14. “Prind” është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

15. “Sistemi i integruar i mbrojtjes” është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësisë dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

16. “Shërbimi psiko-social shkollor” është shërbimi që u ofron mbështetje nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore për identifikimin dhe trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të komunitetit shkollor, i cili sigurohet nga njësitë arsimore vendore.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- a) fëmijën me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) fëmijën me shtetësi shqiptare, i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
3. Barazia dhe mosdiskriminimi.
4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t’i krijuar kushtet e jetesës, për t’i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
5. Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.
8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur



parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Neni 6

Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

KREU II

TË DREJTAT E FËMIJËS

Neni 7

E drejta e jetës

1. Mbrojtja e jetës së fëmijës është e garantuar me ligj. Fëmija gëzon standardet më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit.

2. E drejta e aksesit të fëmijës tek institucionet e kujdesit shëndetësor garantohet pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, racës, etnisë dhe aftësisë ose situatës ekonomike, sociale e ligjore të prindërve apo kujdestarit.

3. Çdo fëmijë që ka nevojë për shërbim shëndetësor ose trajtim mjekësor apo rehabilitues në situata emergjence, vetë ose nëpërmjet prindërve apo kujdestarit, ka të drejtë t'u drejtohet institucioneve të kujdesit shëndetësor ose social për këtë qëllim. Personi ose autoriteti përgjegjës, brenda fushës së kompetencave që ka, i ofron fëmijës ndihmën e menjëhershme dhe e referon atë në institucionin e kujdesit shëndetësor ose rehabilitues më të përshtatshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prindit ose kujdestarit.

4. Në raste përjashtimore, kur jeta e fëmijës rrezikohet ose ka një rrezik për pasoja serioze në jetën dhe shëndetin e fëmijës, mjeku ka të drejtë të kryejë ekzaminimin dhe të japë ndihmën mjekësore, si nevojë imediate për të shpëtuar jetën e fëmijës, edhe nëse prindërit ose kujdestari nuk japin pëlqimin.

Neni 8

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:

a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

b) të ketë një emër;

c) të fitojë shtetësinë;

ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.

2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.

3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihi mund të përfshijë dhënie të informacionit gjenetik për:

a) gjetjen e prindërve;

b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkuar, me qëllim bashkimin familjar;



c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, punonjësi i strukturës së mbrojtjes së fëmijës, kryesisht ose pas marrjes së mendimit të strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale, cakton menjëherë një ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas këtij ligji.

6. Kur fëmija braktiset nga nëna në maternitetet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, personeli social dhe mjekësor i tyre, brenda 24 orëve nga zhdukja e nënës, njofton me telefon dhe me shkrim njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor dhe policinë, në të njëjtën kohë e mënyrë. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, në bashkëpunim me punonjësin e policisë, përgatit raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Nëse gjendja shëndetësore e fëmijës është e mirë, bazuar në raportin e hartuar, njësia e mbrojtjes së fëmijës, pranë pushtetit vendor, merr masa për vendosjen e fëmijës, përkujdesje alternative, sipas nenit 57 të këtij ligji.

7. Në rast se identifikohet njëri nga prindërit, njësia e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor ofron këshillim, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes. Nëse nëna nuk identifikohet pas hetimit të policisë, punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas pikës 6, të këtij neni, vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.

8. Institucionet e kujdesit shëndetësor, të shërbimit social, shërbimet rezidenciale, si dhe të gjithë personat juridikë e fizikë që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, njoftojnë me shkrim punonjësin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ushtrojnë aktivitetin, i cili, në

bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të pushtetit vendor, ndërmerr veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës.

9. Rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor, parashikohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 9

E drejta për të qëndruar me prindërit

1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore.

2. Fëmija, në çdo rast, ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi ose pëlqimi nga gjykata, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

5. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet prindërve, lidhur me mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre për të mbajtur kontakte me fëmijën, gjykata vendos një ditar të përcaktuar me orare, sipas moshës së fëmijës, intensitetit të lidhjes emocionale që fëmija ka me prindin, me të cilin nuk bashkëjeton, sjelljen e këtij të fundit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme për vendimmarrjen e gjykatës në secilin rast. Ky kriter ndiqet nga gjykata edhe në përcaktimin e kontakteve të fëmijës me persona të tjerë të afërt me të.



6. Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:

a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;

b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;

c) banimit të përkohshëm të fëmijës te një i afërm ose person, i cili nuk jeton rregullisht me fëmijën;

ç) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;

d) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;

dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.

7. Për të siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve personale të fëmijës me prindërit ose me persona të tjerë, me të cilët ai gëzon një jetë familjare, si dhe me qëllim kthimin e fëmijës në banesën e tij pas përfundimit të vizitës ose lejjimit të fëmijës për t'u takuar me prindin tjetër, sipas vendimit të gjykatës, kjo e fundit, me kërkesë të prindit të interesuar ose të personit të ngarkuar me mirërritjen e fëmijës, mund të vendosë marrjen e këtyre masave ose garancive:

a) gjobë për vonesë ndaj personit që refuzon të zbatojë orarin e caktuar për mbajtjen e kontakteve me fëmijën;

b) garanci pasurore ndaj prindit që nuk respekton vendimin e gjykatës, kur është e mundur, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

8. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtari i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, arrestuar, burgosur, internuar, dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij.

9. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendqëndrimin e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur një gjë e tillë dëmton mirëqenien e fëmijës. Në rast të mosdhënies së informacionit, prindi ose anëtarë të tjerë të familjes kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos nëse mosdhënia e informacionit është e bazuar.

10. Në rast se prindërit nuk bien dakord për vendbanimin e fëmijës, gjykata vendos për vendbanimin e tij, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, si dhe mban në konsideratë:

a) vullnetin e secilit prind për të përfshirë prindin tjetër në vendime që lidhen me fëmijën dhe të mbikëqyrë të drejtat prindërore të tjetrit;

b) historikun e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës dhe secilit prind, duke përfshirë masën dhe mënyrën se si i kanë plotësuar detyrimet prindërore secili prej tyre kundrejt fëmijës;

c) vullnetin e secilit prind për të lejuar tjetrin të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

ç) statusin e banesës të secilit prind në 3 vitet e fundit;

d) historikun e veprimeve të dhunshme ndaj fëmijës ose ndaj personave të tjerë;

dh) distancën ndërmjet banesës së secilit prind dhe institucioneve të edukimit që ndjek fëmija;

e) mendimin e fëmijës;

ë) vendbanimin e motrave dhe vëllezërve të fëmijës.

11. Këto aspekte mbahen parasysh edhe në rastet kur vendbanimi i fëmijës caktohet pranë institucioneve të tjera të rritjes dhe edukimit ose në rast të mbrojtjes që i ofrohet fëmijës në nevojë për mbrojtje.

Neni 10

E drejta për ribashkim familjar

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.



2. Në rast se prindërit janë migrantë të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija ka fituar shtetësinë shqiptare, prindërit lejohen të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë e të mos largohen nga vendi.

Neni 11

E drejta për t'u zhvendosur nga vendbanimi ose për të siguruar kthimin në vendin e origjinës

1. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjyqësor, pasi të jetë marrë mendimi ose pëlqimi i fëmijës.

2. Mendimi ose pëlqimi i fëmijës merret në konsideratë për çështje që lidhen me kthimin e tij në vendin e origjinës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Me qëllim që fëmija të shprehë mendimin e tij, atij i ofrohet informacion i plotë lidhur me situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që mund t'i ofrohen në vendin e origjinës.

3. Fëmija i pashoqëruar nga prindi ose kujdestari ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë pranë tyre. Kthimi në vendin e origjinës bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të fëmijës, parim, i cili mbahet parasysh gjatë të gjithë procesit. Në këto raste vlerësohen aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritetin e tij në vendin ku do të kthehet, si dhe mundësitë e tij për të ruajtur identitetin, kombësinë, emrin dhe lidhjet familjare, duke marrë parasysh mendimin ose pëlqimin e fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

4. Prindi, kujdestari i fëmijës, ose çdo person që merr dënim për humbjen e tij, duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës.

5. Për rastet që përfshijnë fëmijët e pashoqëruar, shërbimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ndërsa, për rastet që përfshijnë fëmijët e shoqëruar vetëm nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër, njoftohet Ministria e Drejtësisë. Këto organe marrin masa të menjëhershme për kthimin e fëmijës në Shqipëri, sipas rregullave të ligjit nr. 9446, datë 24.11.2005, "Për ratifikimin e Konventës mbi Aspekte Civile

të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës".

6. Procedurat dhe rregullat për kthimin e riadhesimit të fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 12

Liria e shprehjes

1. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti ose me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

2. Fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik, siguria kombëtare ose nderi e dinjiteti apo të drejtat e të tjerëve.

Neni 13

E drejta për t'u dëgjuar

1. Fëmijës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit.

2. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse që lidhen me hartimin e zbatimit e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

3. Fëmija, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, ka të drejtë të ankohet vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit të tij kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të, sipas legjisllacionit në fuqi.

4. Kur fëmija e ushtron vetë këtë të drejtë, punonjësit e administratës së shërbimit civil ose të administratës gjyqësore kanë detyrimin t'i japin këshillimin e nevojshëm.

Neni 14

E drejta e informimit

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj informacioni në lidhje me mirëqenien,



edukimin dhe zhvillimin e tij fizik e psikologjik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Fëmija ka akses në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për të.

Neni 15

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.

2. Prindi ose kujdestari i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në zgjedhjen e një besimi fetar, pasi ka marrë në konsideratë mendimin e tij dhe pa ushtruar forcë në zgjedhjen e fëmijës, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.

3. Nëse fëmija ndodhet në kushtet e mbrojtjes, personat që janë ligjërisht përgjegjës për të ndalohen të marrin masa të tilla, që ndikojnë në besimin fetar të fëmijës.

Neni 16

Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore

1. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore. Ndalohet detyrimi i fëmijës për tubim në kundërshtim me vullnetin e tij.

2. Ushtrimi i kësaj lirie bëhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

3. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat mbikëqyrin nëse kjo e drejtë garantohet nga institucionet përgjegjëse, sipas këtij ligji dhe, në rast mosrespektimi, njoftojnë organet e policisë për marrjen e masave konkrete, sipas legjislacionit në fuqi, duke mbajtur në vëmendje sigurinë e fëmijës gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.

4. Mosrespektimi i detyrimit të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

Neni 17

Liria e jetës private

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.

2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institu-

cioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

3. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.

4. Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike, si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës.

5. Fëmijët nuk mund të përdoren apo të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike apo private për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike.

6. Mosrespektimi i këtij ndalimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

7. Transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të lirive dhe të drejtave të fëmijës gjatë transmetimit të programeve të tyre, në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

8. Rastet përjashtimore nga mbrojtja e privatësisë bëhen vetëm nëse i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 18

E drejta për arsimim

1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.

2. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:

a) të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për



të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;

b) të zhvillojnë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, programe edukimi për prindërit, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;

c) të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrin nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;

ç) të organizojnë plane mësimore të veçanta edukimi për fëmijët që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, ose pranë institucioneve joshkolllore, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;

d) të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;

dh) të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;

ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;

f) të ndër marrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimit të fëmijës që i përket grupeve ose rajoneve me mangësi të konsiderueshme edukimi ose që është në situata të vështira sociale, ekonomike ose gjendje fizike apo mendore të veçantë, ose që lidhen me aspekte të gjinisë, besimit fetar ose praktikave kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor etnik ose vijnë nga një situatë migratore;

g) të ngrenë mekanizma efikasë për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);

gj) të parashikojnë dhe zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.

h) të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë.

4. Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mosregjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, pranë pushtetit vendor merr masa të menjëhershme për regjistrimin të fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara.

6. Fëmija ka të drejtë të ankohet ndaj vlerësimeve të dijeve të tij, sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar.

Neni 19

E drejta për pushim dhe argëtime kulturore e sportive

1. Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirish në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën e tij.

2. Autoritetet publike qendrore e vendore, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët. Ato krijojnë hapësira të nevojshme, brenda mundësive, për lojërat e fëmijës. Këto masa përfshijnë:

a) miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, si dhe të akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe aksesin e sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike;

b) vendosjen e standardeve të sigurisë dhe aksesimit për të gjitha mjediset çlodhëse e këndet e lojërave, me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit;



c) krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare;

ç) hartimin e kurrikulave shkollore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.

Neni 20

E drejta për nivel jetese të përshtatshëm

1. Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Prindi ose kujdestari kanë detyrimin dhe përgjegjësinë parësore për t'i siguruar, brenda aftësive dhe mundësive financiare që ata kanë, kushtet më të mira të jetesës, të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

3. Çdo fëmijë gëzon të drejtën e aksesit në programe për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, duke përfshirë aksesin në çerdhe, kopshte ose programe të tjera zhvillimi, si dhe të drejtën e ushqimit gjatë ndjekjes së këtyre programeve, sipas standardeve të parashikuara në akte nënligjore.

4. Organet e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet përgjegjëse në varësi të tyre marrin masat e nevojshme për të ndihmuar prindin ose kujdestarin të ushtrojë këtë të drejtë, në rast se ka nevojë për asistencë materiale ose programe mbështetëse.

Neni 21

E drejta për kujdes shëndetësor

1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor falas dhe e standardit më të lartë, si dhe përfitimi nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet, pavarësisht nëse fëmija është i regjistruar ose jo në regjistrin e gjendjes civile ose nëse prindërit e fëmijës kanë paguar ose jo taksat.

2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, e cila merr masa:

a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;

b) për t'u siguruar të gjithë fëmijëve kujdesin shëndetësor falas e cilësor, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;

c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

ç) për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;

d) për të mundësuar, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, që të gjitha grupet shoqërore dhe, në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe përmirësimin e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;

dh) për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues dhe për të nxitur jetesën e shëndetshme të fëmijët, këshillimin e prindërve dhe fëmijës, edukimin dhe shërbimet në fushën e shëndetit riprodhues për prindërit dhe fëmijët, në varësi të moshës dhe aftësisë së tyre për të kuptuar;

e) për verifikimin periodik të trajtimit që i bëhet fëmijës së vendosur në institucione të kujdesit shëndetësor ose në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme, me vendim të gjykatës;

ë) për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë dhe pas ekzaminimit mjekësor të fëmijës, ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur rrezikohet shëndeti ose jeta e fëmijës, sipas nenit 67 të këtij ligji;

f) për ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim riaftësimin dhe përfshirjen sociale të tyre, si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë si të gjithë fëmijët.

3. E drejta e fëmijës për të pasur akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe të rehabilitimit, si dhe marrja e mjekimit të përshtatshëm për sëmundjen që ka garantohet nga shteti dhe shpenzimet mbulohen nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjisllacionit në fuqi.

4. Prindërit kanë detyrimin të kërkojnë kujdes mjekësor, me qëllim që fëmija të gëzojë standardin më të lartë shëndetësor, si dhe për të parandaluar situata që mund të jenë të rrezikshme për jetën, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

5. Vizitat periodike të punonjësve të konsultores së nënës dhe fëmijës në banesën e gruas shtatzënë



dhe fëmijës deri në moshën 1 vjeç janë të detyrueshme. Ato kryhen sipas paketës bazë të shërbimeve të kujdesit parësor e protokolleve standarde për këto shërbime dhe bëhen me qëllim mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës, duke përfshirë këshillimin për mirëritjen e fëmijës, parandalimin dhe shmangien e braktisjes së fëmijës, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhimin ose çdo lloj tjetër dhune ndaj fëmijës.

Neni 22

E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror

1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë nga shërbimi i kujdesit shoqëror, drejtpërdrejt apo nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.

2. Në rast se prindi/prindërit ose personi/personat që kujdesen për fëmijën nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për shkaqe që nuk varen prej vullnetit të tyre, nevojat minimale të fëmijës për strehim, ushqim, veshmbathje dhe edukim, ofrohen nga shteti, kur kjo kërkohet prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.

3. Çdo institucion publik ose jopublik që ushtron aktivitet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës ka detyrimin t'u japë prindërve të gjithë informacionin e nevojshëm për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

1. Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Fëmija mbrohet edhe nga të gjitha format e migracionit të paligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

2. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me institucionet e kujdesit shëndetësor, të edukimit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës

viktimit e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Subjektet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin e vetëvendosjen e fëmijës, në përputhje me moshën e tij.

4. Ndalohet ndëshkimi trupor ose i ndonjë forme tjetër, që sjell pasojë në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Neni 24

Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik

1. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që:

- a) paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor;
- b) cenon edukimin;
- c) është e detyruar.

2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës.

3. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune të detyruar brenda familjes së tij, në shkollë, institucione të rehabilitimit dhe dënimit, ose në aktivitete kulturore, artistike, sportive, modelimi ose për qëllime reklamuese, që paraqet rreziq, cenon edukimin, dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

4. Ndalohet çdo praktikë, nëpërmjet së cilës fëmija detyrohet të kryejë veprime të përmendura në pikat 2 e 3, të këtij neni, pavarësisht dënjesisë ose jo të prindit ose kujdestarit, si dhe pavarësisht faktit nëse është apo jo kundrejt shpërblimit.

5. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimit i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.



Neni 25

Mbrojtja nga përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope

1. Fëmija mbrohet nga:

a) përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope;

b) prodhimi dhe trafiku i paligjshëm i këtyre substancave.

2. Ndalohet shitja e përzierësve ose tretësve për prodhimin ose përdorimin e substancave narkotike e psikotrope, duhanit, si dhe pijeve alkoolike të fëmijët.

3. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, brenda kompetencave, marrin masa, me qëllim:

a) parandalimin e përfshirjes së fëmijës në prodhimin, shpërndarjen dhe trafikimin e substancave narkotike;

b) rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe të fëmijës për këtë çështje, përfshirë edhe hartimin e kurrikulave të nevojshme për këtë qëllim;

c) përkrahjen e fëmijës dhe familjeve të tyre nëpërmjet këshillimit;

ç) hartimin e politikave, strategjive dhe shërbimeve që garantojnë rehabilitimin fizik, mendor dhe social të fëmijës që përdor alkool, duhan ose substanca narkotike e psikotrope.

4. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e qeverisjes vendore mbështesin fëmijën dhe familjen nëpërmjet referimit të çështjes të shërbimet e specializuara për këtë qëllim.

Neni 26

Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual

Fëmija mbrohet nga trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi.

Neni 27

Mbrojtja e fëmijës nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet

1. Prindi, kujdestari ose çdo person tjetër, i cili është në kontakt me fëmijën është përgjegjës për të mbrojtur fëmijën nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet.

2. Qendrat e ofrimit të internetit, institucionet e edukimit, si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, i cili ofron akses në internet, aplikojnë instrumente teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe ose të dëmshme, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, kur konstaton se në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit, në faqet e internetit apo në mjedise ku ka fëmijë, qarkullojnë materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, sipas këtij ligji dhe ligjit për sigurinë kibernetike, i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masat për bllokimin e aksesit në këto rrjete ose faqe.

4. Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Mbrojtja nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe në situata të emergjencave civile

1. Fëmija nuk lejohet të përfshihet drejtpërdrejt dhe tërthorazi në një konflikt të armatosur.

2. Në rast konflikti të armatosur ose në situata emergjence civile, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër.

3. Nëse fëmija arrestohet ose ndalohet për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur, ai mbahet në mjedise të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij.

4. Njësia e mbrojtjes së fëmijës në çdo njësi të qeverisjes vendore, brenda 24 orëve nga nisja e një konflikti të armatosur ose emergjence civile, harton një listë me të gjithë fëmijët që ndodhen në



territorin e njësisë përkatëse administrative dhe ia dërgon atë Drejtorisë për Emergjencat Civile, me qëllim mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e posaçme të tyre gjatë konfliktit.

5. Në raste të evakuimit të popullsisë gjatë një konflikti të armatosur ose emergjence civile, fëmijës i jepet prioritet. Drejtoria për Emergjencat Civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës marrin masat e nevojshme për evakuimin e sigurt të fëmijës. Në çdo rast, fëmija nuk ndahet nga prindërit ose familja e tij.

Neni 29

E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor

1. Fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.

2. Ndihma juridike dhe psikologjike i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.

3. Ndihma juridike ndaj fëmijës përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor.

4. Ndihma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

5. Fëmija, vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij, bën kërkesë për ndihmë juridike tek institucionet përgjegjëse, të cilat informojnë fëmijën, kujdestarin ose përfaqësuesin e tij për procedurat sipas legjislacionit në fuqi.

6. Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

Neni 30

Ushtrimi i kujdesit prindëror

1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.

2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezulton se qëndrimi i mëtëjshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj.

3. Prindërit e fëmijës, pavarësisht faktit se cili prej tyre ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë të drejtë të marrin informacion dhe asistencën e nevojshme për mirërritjen, kujdesin dhe edukimin e fëmijës, të marrin informacion për fëmijën nga shkolla, njësitë e shërbimit shëndetësor ose çdo institucion tjetër në kontakt me fëmijën.

4. Në rast se të dy prindërit ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, por nuk bashkëtojnë me njëri-tjetrin, vendimet lidhur me zgjedhjen e edukimit ose trajnimit profesional, trajtimet mjekësore komplekse ose ndërhyrjet kirurgjikale, vendbanimin e fëmijës ose administrimin e pasurisë së tij, merren me pëlqimin e të dy prindërve.

5. Në rast se njëri nga prindërit nuk jep pëlqimin e tij për të marrë vendim, lidhur me çështjet e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, ose kur ai nuk mund të kontaktohet për shkak të vendndodhjes së panjohur ose për shkak të nevojës urgjente për të marrë vendim lidhur me fëmijën, vendimet merren nga prindi që jeton me fëmijën, përveç rasteve kur vendimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

6. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet prindërve lidhur me ushtrimin e të drejtave prindërore dhe realizimin e detyrimeve të tyre ndaj fëmijës, cilido prej tyre mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente. Pasi të jenë dëgjuar të dy prindërit, si dhe të jetë marrë mendimi i fëmijës, gjykata vendos në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 31

Përkujdesja alternative

1. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi



gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. Në zbatimin e kësaj mase i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar, sipas interesit më të lartë të fëmijës.

2. Përkujdesja alternative mund të jetë:

a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës;

b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën;

c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe.

3. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje, sipas nenit 55 të këtij ligji.

4. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

Neni 32

Fëmija me aftësi të kufizuar

1. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.

2. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfutur nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.

3. Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t'i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojës.

4. Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim.

Shpenzimet, në këtë rast, mbuloohen nga buxheti i të dyja njësitë të qeverisjes vendore. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, ministrit përgjegjës për shëndetësisë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

5. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive, që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

6. Autoritetet përgjegjëse garantojnë përshtatjen e arsyeshme rast pas rasti.

7. Autoritetet përgjegjëse garantojnë pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe legjislacionit përmes informacionit të përshtatur, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijët për të kuptuar.

Neni 33

Fëmija që i përket pakicave kombëtare

1. Fëmija që i përket një pakice etnike, fetare ose gjuhësore ka të drejtë të ushtrojë jetën e tij kulturore, të deklarojë përkatësinë e tij etnike e fetare, të ushtrojë besimin e tij fetar, si dhe të përdorë gjuhën e tij me anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilit i përket.

2. Fëmija që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë të shprehet në gjuhën e tij amtare gjatë procedurave që lidhen me çështjet e tij.

3. Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të parashikuara në këtë nen garantoohen duke mbajtur parasysh respektimin edhe të të drejtave të fëmijëve të tjerë.

KREU III

MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Neni 34

Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

1. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës,



në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

2. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:

a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror;

b) grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.

3. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë:

a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

c) çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

4. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:

a) bashkia;

b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësieve administrative;

d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

5. Mekanizmat dhe strukturat në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit e të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këta mekanizma dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Neni 35

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

2. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës.

3. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.

4. Përfaqësuesit nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës duhet të jenë shtetas shqiptarë, të cilët të kenë njohuri dhe të kenë marrë pjesë në veprimtari të shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Përfaqësuesit nga shoqëria civile zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile.

5. Mandati i anëtarëve të Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë ndalohet.

6. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka të drejtë të ngrëjë komitete teknike këshilluese për çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe të përcaktojë përbërjen e rregulloret e tyre.

7. Zgjedhja e përfaqësuesve të fëmijës dhe të shoqërisë civile realizohet sipas udhëzimeve të



Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

8. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me të drejtat e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson gjendjen konkrete të respektimit të të drejtave të fëmijës në Shqipëri, duke marrë në konsideratë angazhimet shtetërore, në kuadër të Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe traktateve të tjera në fushën e të drejtave të njeriut;

b) vlerëson planifikimin e buxhetit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve;

c) jep rekomandime të posaçme për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

ç) bën propozime dhe jep rekomandime për Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e legjislacionit në fushat përkatëse të zbatimit të të drejtave të fëmijës.

Neni 37

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me mbrojtjen e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson dhe analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës;

b) i propozon ministrit përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës programet kryesore shtetërore për mbrojtjen e fëmijës dhe drejtimin e politikave shtetërore për përmirësimin e gjendjes së trajtimit të tyre;

c) rekomandon shërbime dhe programe të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre;

ç) rekomandon shërbime dhe programe parandaluese ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijës;

d) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 38

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse realizon këto detyra:

1. Në lidhje me orientimin e monitorimin e politikave shtetërore dhe situatës së të drejtave të fëmijës:

a) koordinon dhe monitoron zhvillimin e zbatimit të politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përgatit raportet përkatëse;

b) kontrollon veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe miraton raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës;

c) orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët;

ç) ofron mbështetje për organizatat jofitimprurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;

d) bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

dh) analizon të dhënat e raporteve statistikore e të raporteve të tjera dhe koordinon me ministrat e tjerë, me qëllim që të përshtatë në mënyrë dinamike politikat e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

2. Në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, realizon këto detyra:

a) merr masa, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, për ngritjen dhe mirëfunksionimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase për mbrojtjen e tyre, nëpërmjet shërbimeve shumëdisiplinore,



ndërsektoriale, të koordinuara, me në qendër fëmijën.

b) harton politika, programe shtetërore dhe strategji në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe shërbimeve për fëmijët, si dhe planifikon shpërndarjen e buxhetit për arritjen e tyre;

c) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre, kryesisht dhe në bazë të rekomandimeve të propozuara nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

ç) nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore;

d) bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

dh) siguron ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, sipas këtij ligji dhe standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

e) siguron ngritjen e një sistemi për akreditimin, kontrollin e cilësisë dhe ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës;

ë) është përgjegjës për ngritjen e një regjistri elektronik kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe merr masa për miratimin e akteve nënligjore për ta bërë të detyrueshëm përdorimin e këtij regjistri.

3. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

4. Mënyra e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Detyrat e ministrave

Ministrat, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, nëpërmjet strukturave të tyre politikëbërëse, kanë për detyrë:

a) të sigurojnë zbatimin e plotë të këtij ligji dhe realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, të njohura nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

b) të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të fëmijës;

c) të shoqërojnë çdo projektligj apo projektakt normativ që hartojnë me një analizë të ndikimit të tij te fëmijët, djem dhe vajza;

ç) të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen e fëmijës;

d) të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar që punonjësit dhe strukturat në varësi të tyre, që merren me mbrojtjen e fëmijës, të përgatiten me njohuritë e duhura dhe të specializohen në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 40

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është person juridik në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, financuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera, sipas ligjit.

2. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil.

3. Struktura dhe organika e agjencisë miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

4. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e agjencisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 41

Detyra e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për paranda-



limin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

2. Agjencia ka për detyrë t'u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me:

a) koordinimin me agjenci të tjera shtetërore dhe private;

b) zhvillimin e aktiviteteve profesionale, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës;

c) asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe supervizionin, në raste të caktuara; bashkërendim të punës për raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës;

ç) këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, për të cilën agjencia nxjerr një urdhër të brendshëm për mënyrën e funksionimit.

3. Agjencia ka për detyrë gjithashtu:

a) të mbledhë të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje;

b) të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimit;

c) të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes;

ç) të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje;

d) në zbatim të nenit 11, pika 6, e këtij ligji, të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për realizimin e procesit të mbrojtjes dhe marrjes së masave për menaxhimin e rasteve të fëmijës në situatë migrimi, në situatë ndërkuftare dhe në nevojë për mbrojtje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të fëmijës së pashoqëruar.

Neni 42

Detyrat e agjencisë në lidhje me bashkërendimin e punës me ministrin përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe

mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.

2. Përgatit dhe i propozon ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës udhëzime metodologjike për strukturat e mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore dhe koordinimin ndërsektorial në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

3. Bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

4. I paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Neni 43

Detyrat e agjencisë në lidhje me politikat dhe veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

2. Ndërton dhe realizon vetë apo në bashkëpunim me institucione të tjera veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit të drejtësisë.

3. Koordinon ose realizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijës në të gjitha fushat.

4. Inicion dhe zbaton projekte pilot, në bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe u jep mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

5. Organizon dhe bashkërendon kërkime shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.



6. Realizon mbledhjen, analizën e të dhënave dhe raportimin e zbatimit të dokumenteve strategjike me fokus fëmijët, si dhe të situatës së të drejtave të fëmijës.

7. Zhvillon dhe mirëmban një sistem informacioni me fokus institucionet e specializuara për fëmijët, organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të dhëna të tjera, që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.

8. Bashkërendon veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera.

Neni 44

Mbështetja e agjencisë nga autoritetet shtetërore

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me agjencinë, për realizimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ngritjes dhe zbatimit të standardeve për një sistem funksional të integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

2. Llojet, mënyra e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga agjencia pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45

Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe ata që punojnë me fëmijët

1. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, nuk mund të punësohen dhe, kur janë të punësuar, përfundojnë marrëdhënien e punës në rast se:

a) janë dënuar me dënim të formës së prerë për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje;

b) ndaj tyre është marrë, me vendim gjykatë, një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje.

2. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit që punojnë me fëmijët pezullohen nga detyra kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj të miturve ose kur ata akuzohen për kryerjen e një veprë penale në bashkëpunim me të mitur.

3. Kriteret për punësimin e punonjësit të

strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46

Roli i bashkisë

Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të standardeve dhe, nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, duke siguruar, ndërmjet të tjerash:

a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në planet e zhvillimit vendor, në programet dhe projektet, në përputhje me politikat kombëtare;

b) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës;

c) zhvillimin e programeve dhe projekteve për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës;

ç) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera vendore, për situatën e të drejtave të fëmijës dhe familjeve, me qëllim hartimin e programeve që krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin optimal të fëmijës;

d) zbatimin e politikave kombëtare të mbrojtjes së fëmijës dhe masave të mbrojtjes, siç parashikohen në këtë ligj;

dh) ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, sipas këtij ligji, duke krijuar kushtet për funksionimin e tyre, në përmbushje të funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë edhe shpërndarjen e fondeve përkatëse, në mënyrë që strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor të funksionojnë në mënyrë efektive;

e) zbatimin e procedurës për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si dhe për ngritjen e koordinimit të sistemit të referimit, raportimit, të marrjes në mbrojtje dhe të ndjekjes së rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje nëpërmjet strukturave të saj;

ë) organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve me bazë komunitare për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe shërbimeve mbështetëse për familjet e shërbime të përkujdesjes alternative për fëmijët;



f) ngritjen e programeve dhe të shërbimeve rehabilituese e rinte-gruese për fëmijët në nevoje për mbrojtje, me një fokus të veçantë për fëmijët viktimë të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit dhe fëmijët që dyshohen apo kanë kryer vepra penale, të cilët janë nën moshën për përgjegjësi penale;

g) kontributin për ngritjen dhe menaxhimin e sistemit kombëtar të informacionit për mbrojtjen e fëmijës, brenda kompetencave të tyre;

gj) financimin e shpenzimeve për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe të Planit për Aftësim Prindëror.

Neni 47

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo, nëpërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore i raporton kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak për ecurinë e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore ngre grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie dhe, kur është e nevojshme, në nivel njësie administrative, si dhe koordinon e mbikëqyr punën dhe aktivitetin e tij, sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 48

Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore

1. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore është përgjegjës për:

a) marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në propozimin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe të grupit teknik ndërsektorial;

b) miratimin dhe koordinimin e veprimeve ndërsektoriale me institucionet shtetërore për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes;

c) marrjen e masave për koordinimin me njësitë përkatëse brenda bashkisë për realizimin e prokurimit të shërbimeve të nevojshme për realizimin e Planit Individual të Mbrojtjes, kur ato nuk mbulohen dot nga strukturat shtetërore;

ç) marrjen e masave për organizimin dhe planifikimin e një shërbimi mbrojtjeje emergjente 24-orësh, i cili i njoftohet edhe strukturave të Policisë së Shtetit;

d) monitorimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve për mbrojtjen e garantimin e aksesit në të drejtat e fëmijës në territorin e bashkisë;

dh) raportimin për ecurinë e veprimtarisë së njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe për situatën e fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

2. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës miraton, me udhëzim, mënyrën e vendosjes, në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën, ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje.

Neni 49

Njësia për mbrojtjen e fëmijës

1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

2. Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përveç detyrave të parashikuara në nenin 51, të këtij ligji, është përgjegjës dhe ka për detyrë:

a) të mbështesë punonjësën për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, masat e mbrojtjes dhe planet individuale të mbrojtjes në bazën e të dhënave përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie dhe njësie administrative;



c) të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;

ç) t'i raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësitë administrative përkatëse;

d) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;

dh) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;

e) të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

ë) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.

4. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve proceduralë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrit të Drejtësisë.

5. Njësia për mbrojtjen e fëmijës ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkisë

1. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkive janë pjesë e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.

2. Çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka, minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësia administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përshkrimin e punës funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 51

Detyrat e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë:

a) të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;

b) të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

c) të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;

ç) të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;



d) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;

dh) të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes. Profesionistët e tjerë, të përfshirë në zbatimin e masës së mbrojtjes apo të Planit Individual të Mbrojtjes, janë të detyruar ta mbajnë të informuar punonjësën e mbrojtjes së fëmijës në lidhje me progresin, sfidat dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të tyre;

e) të propozojë ndryshimin apo heqjen e masës së mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes nëse nuk ekzistojnë më kushtet, për shkak të të cilave është vendosur masa dhe plani, apo kur një gjë e tillë i shërben fëmijës dhe/ose është në interesin më të lartë të tij;

ë) të lehtësojë dhe të mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në përmblidhjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes;

f) të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxher rasti;

g) t'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

gj) të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.

Neni 52

Grupi teknik ndërsektorial

1. Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet *ad-hoc*, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

2. Grupi teknik ndërsektorial thirret nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në

nivel bashkie, ose nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në nivel njësie administrative.

3. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial.

4. Në takimet e grupit teknik ndërsektorial thirren të marrin pjesë:

a) anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik;

b) prindërit apo anëtarët e familjes ose kujdestarët e fëmijës;

c) fëmija, bazuar në moshën dhe në aftësinë e tij për të kuptuar dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

5. Grupi teknik ndërsektorial mbështet punonjësën e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

6. Funksionimi i grupit teknik ndërsektorial rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

MASAT E MBROJTJES SË FËMIJËS

Neni 53

Mbrojtja e fëmijës

Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja e mbrojtja e prindërve ose kur, për shkak të interesit të tij më të lartë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.



Neni 54

Plani Individual i Mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësitë e vlerësimit dhe të Referimit të Rasteve dhe grupin teknik ndërsektorial, që funksionon në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë, duhet të hartojë një Plan Individual Mbrojtjeje, i cili përmban edhe propozimin për masën e mbrojtjes, kur është e nevojshme.

2. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, përveç masave të mbrojtjes, edhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme, që realizojnë respektimin dhe lehtësojnë aksesin e fëmijës në të drejtat e tij, si dhe shërbimet shoqërore apo shërbime të tjera të nevojshme, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit.

3. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, sipas rastit, masat për hetimin dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rastet kur fëmija është në rrezik për abuzim, dhunë, neglizhim e shfrytëzim dhe ndihmën mjekësore, shërbimin psikologjik, ligjor, shoqëror apo çdo shërbim tjetër të nevojshëm rehabilitues apo riintegruar, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit, si edhe aktivitete edukative, mësimore e argëtuese për fëmijën, masat për riaftësim prindëror, programet e mbështetjes dhe ndihmës për prindërit, kujdestarin dhe anëtarët e familjes së gjerë.

4. Të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet e parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes ofrohen falas.

5. Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimi e përmbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 55

Masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes janë:

a) masa emergjente e mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative;

b) masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative;

c) masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

2. Masat e mbrojtjes vendosen për fëmijën:

a) prindërit e të cilit kanë vdekur ose janë shpallur të vdekur nga gjykata, janë të panjohur, u është hequr përgjegjësia prindërore dhe janë në kushte nevojë për mbrojtje;

b) prindi ose kujdestari ligjor i të cilit është shoqëruar, ndaluar, arrestuar ose dënuar me heqje lirie dhe fëmija është në nevojë emergjente mbrojtjeje;

c) kur, në interesin e tij më të lartë, nuk mund të lihet në kujdesin prindëror, për shkak se rrezikohet integriteti i tij fizik, moral, psikologjik e emocional;

ç) i cili është abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar ose neglizhuar;

d) i cili është braktisur nga prindërit që në lindje ose është nën moshën 16 vjeç dhe askush nuk është duke u kujdesur për të;

dh) i cili ka kryer një vepër penale dhe, për shkak të moshës, nuk ka përgjegjësi penale;

e) i cili ka, dyshohet ose akuzohet ose është dënuar se ka kryer një vepër penale, është në gjendje të lirë dhe ka nevojë për mbrojtje.

Neni 56

Masa emergjente e mbrojtjes

1. Masa emergjente e mbrojtjes për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje, e cila vendoset për fëmijën që ndodhet në situatat e mëposhtme:

a) kur fëmija vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo formë dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku fëmija qëndron nuk është e sigurt për fëmijën;

b) është braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) është pa përkujdes prindëror, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situatë të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

2. Gjatë kohës së vlefshmërisë së një mase emergjente mbrojtjeje, dhënë nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, apo të vendimit të gjykatës për konfirmimin e saj, prindërit nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.



3. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Neni 57

Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative

1. Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje për fëmijën pa përkujdesje prindërore dhe kur për mbrojtjen e tij është e nevojshme strehimi apo vendosja e tij në përkujdesje alternative, duke ndjekur këtë radhë:

- a) pranë një të afërmi të fëmijës;
- b) pranë një familjeje kujdestare;
- c) në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme.

2. Marrja e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative merr parasysh mosndarjen e motrave dhe vëllezërve.

3. Vendimi për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata për konfirmimin ose jo të saj dhe ka të njëjtat efekte si vendimi i gjyqësor për kujdestarinë.

4. Personat apo institucioni, pranë të cilit vendoset fëmija në përkujdesje alternative, ka të njëjtat detyra, përgjegjësi dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes, ndërsa prindërit e fëmijës, gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

5. Gjatë zbatimit të kësaj mase mbrojtëse, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek me përparësi këto çështje:

- a) trajtimin dhe gjendjen psiko-emocionale të fëmijës së vendosur në përkujdesje alternative;
- b) ndihmën dhe krijimin e mundësive për prindërit për të mbajtur kontakte e marrëdhënie personale me fëmijët e tyre;
- c) përgatitjen e dokumenteve përkatëse, të kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor, të konfirmimit ose jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari;

ç) nevojën për ndryshimin apo heqjen e masës mbrojtëse, në varësi të progresit, kushteve dhe rrethanave të rastit.

6. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Neni 58

Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar

1. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

2. Kjo masë vendoset edhe në rastet kur fëmija mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësitë dhe mundësitë për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, i cili dyshohet ose provohet se ka abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën dhe i cili nuk banon apo i cili, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo një urdhri mbrojtjeje nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje.

3. Plan Individual i Mbrojtjes, i cili përmban edhe masën e mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar, hartohet në bashkëpunim me prindërit ose njërin nga prindërit. Në rast se prindërit nuk bashkëpunojnë apo nuk japin miratimin e tyre për ndjekjen e fëmijës me këtë masë mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes së fëmijës vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes.

Neni 59

Vendimmarrja për masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes, ndërhyrjet për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe shërbimet e nevojshme për fëmijën vendosen dhe zbatohen bazuar në Planin Individual të Mbrojtjes.

2. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie apo njësie administrative ose drejtori i njësisë së mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie i dërgon Planin Individual të Mbrojtjes, së bashku



me propozimin për masën e mbrojtjes, drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, i cili merr vendimin e masës së mbrojtjes brenda 24 orëve. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij. Në rastin e masave emergjente të mbrojtjes apo masave të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative vendimi ka fuqi deri në marrjen e vendimit gjyqësor përkatës. Vendimi për dhënien e masës së mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar ka fuqi deri në shfuqizimin e masës nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, bazuar në propozimin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës, dhe nuk dërgohet për shqyrtim gjyqësor.

3. Masat e mbrojtjes për fëmijët mbi moshën 14 vjeç vendosen vetëm pasi është marrë pëlqimi i fëmijës. Në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë marrja e masës së mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, vendim, i cili është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi gjyqësor nga gjykata për lënien në fuqi, kur për këtë masë përkatëse parashikohet shqyrtimi gjyqësor, sipas këtij ligji.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Vendimi i gjykatës për dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata vlerëson si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës dhe vendosjen e tyre në kujdestari.

6. Gjykata vendos për heqjen e masës së mbrojtjes mbi bazën e kërkesës së punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor verifikohet se kanë pushuar shkaqet që kanë çuar në vendosjen e saj.

7. Gjykata kompetente në lidhje me masat e mbrojtjes dhe vendosjen në kujdestari për shkak të këtij ligji është gjykata e rrethit gjyqësor.

8. Veprimtaria e punonjësve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, në lidhje me marrjen dhe zbatimin e masave të mbrojtjes dhe planeve individuale të mbrojtjes është objekt kontrolli nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore.

Neni 60

Monitorimi i masave të mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për monitorimin e masave të mbrojtjes së fëmijës. Ai duhet të raportojë te drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, të paktën një herë në muaj, për mbarëvajtjen, progresin e masës dhe/ose për nevojën e ndryshimit apo heqjen e saj.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës i dërgon propozimin për heqjen e masës së mbrojtjes dhe kthimin e fëmijës në familjen e tij drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, duke e shoqëruar atë edhe me dokumentacionin përkatës, që vërteton se prindërit janë në gjendje të kujdesen për fëmijën dhe kthimi i fëmijës në familje nuk do ta ekspozojë atë në ndonjë rrezik të mundshëm për jetën dhe integritetin e tij fizik, psikologjik moral apo emocional.

3. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nëse e miraton propozimin për heqjen e masës mbrojtëse, autorizon punonjësën për mbrojtjen e fëmijës për të paraqitur kërkesën për heqjen e masës mbrojtëse, nëse ajo është konfirmuar nga gjykata kompetente.

4. Në rast se, në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, prindërit kanë qenë të detyruar të ndjekin kurse prindërimi apo të kryejnë ndonjë veprim tjetër, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës verifikon përfundimin me sukses të këtyre detyrimeve për prindërit dhe përfshin informacionin përkatës në propozimin për heqjen e masës mbrojtëse.

Neni 61

Masat për aftësim prindëror

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkë-



punim me strukturat e tjera të bashkisë ose me njësinë për vlerësimin dhe referimin e rastit në nivel njësie administrative, ka për detyrë të vlerësojë situatën familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe të synojnë në çdo rast, me përparësi, realizimin e mbrojtjes së tij pranë familjes.

2. Në rastet kur për fëmijën merren masa mbrojtjeje të vendosjes në përkujdesje alternative, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, kur është e mundur, harton një plan për aftësim prindëror, i cili është pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijës dhe synon të përgatisë prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse.

3. Plani për aftësim prindëror mund të përmbajë masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror, këshillim psikologjik, për menaxhimin e zemërimit, trajtim mjekësor kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope, trajtim të shëndetit mendor, si dhe ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile, në skemën e ndihmës ekonomike, në shërbimet e punësimit, pranë shërbimit shëndetësor, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

4. Zbatimi i planit për aftësimin prindëror ndiqet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me punonjësit e njësisë së vlerësimit dhe referimit të rasteve.

KREU V

MBROJTJA E POSAÇME PËR KATEGORI TË CAKTUARA FËMIJËSH

Neni 62

Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës janë përgjegjëse për të verifikuar dhe trajtuar, duke ofruar mbrojtjen e nevojshme për çdo rast të identifikuar apo raportuar të fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe dhunuar. Këto struktura, në bashkëpunim me strukturat dhe autoritetet e tjera përgjegjëse vendore, duhet të realizojnë zbatimin e masave të mbrojtjes, ndërhyrjeve dhe shërbimeve të nevojshme të specializuara për të përmbushur të gjitha nevojat e fëmijës viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në

interesin më të lartë të tij, kanë të drejtë të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik, si dhe në rezidencën e personit juridik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Kur, në bazë të rrethanave dhe fakteve është e nevojshme, strukturat e mbrojtjes së fëmijës kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit.

3. Prindi, personi ligjërisht përgjegjës, qoftë person fizik apo juridik, ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe t'u ofrojë atyre informacionin e nevojshëm për adresimin e situatës apo të rastit. Në rast se personat e mësipërm refuzojnë të bashkëpunojnë apo ndalojnë strukturat e mbrojtjes të bëjnë verifikimet e nevojshme, atëherë verifikimi bëhet forcërisht, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit. Mosbashkëpunimi ose ndalimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijës për verifikim, kur nuk përbën veprë penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

4. Në rast se strukturat e mbrojtjes së fëmijës, pas vlerësimeve të bëra, arrijnë në konkluzionin se ka arsye të qenësishme, të cilat mbështesin ekzistencën e një situatë të rrezikut të lartë/të menjëhershëm për fëmijën, atëherë ato kanë të drejtë të marrin masën emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

5. Në rast se nga vlerësimi i rastit të fëmijës rezulton se abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi apo dhunimi është kryer nga persona ligjërisht përgjegjës për përkujdesjen e fëmijës, si punonjës të institucioneve publike apo private të përkujdesjes, kujdestare, familje kujdestare, të afërm, tek të cilët është vendosur fëmija për shkak të një mase mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes marrin masa të menjëhershme për veçimin e fëmijës nga këta persona dhe njoftojnë menjëherë organet e policisë dhe të prokurorisë.

6. Në rastet e dhunës në familje, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, i cili shërben edhe si menaxher rasti, përveç kërkesës për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes, sipas nenit 59, të këtij ligji, mund të iniciojë procesin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes pranë gjykatës kompetente. Në këtë rast, të dyja kërkimet gjykohen nga i njëjti gjyqtar.



7. Në çdo rast, pas vlerësimeve të mësipërmeve, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, i cili përmban masën e mbrojtjes përkatëse, ndërhyrjet e nevojshme dhe shërbimet për të cilat ka nevojë fëmija, me qëllim trajtimin e tij në aspektin shëndetësor e psiko-emocional, si dhe rehabilitimin e riintegrimin e tij. Po kështu, kur është i mundur qëndrimi i fëmijës pranë familjes apo kur fëmija presupozohet se do të kthehet pranë familjes, pavarësisht marrjes së masës së mbrojtjes për vendosje në përkujdesje alternative, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton dhe merr masa për zbatimin e një plani për aftësim prindëror.

8. Të dhënat në lidhje me vlerësimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës së abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar, dhunuar mbahen konfidenciale, përveç rastit kur ato përdoren përpara organeve të drejtësisë.

9. Fëmija shoqërohet, në çdo rast, nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ose një psikolog i caktuar nga ky i fundit, sipas Planit Individual të Mbrojtjes, në çdo procedurë përpara organeve të policisë, të prokurorisë apo gjykatës.

10. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr masa për monitorimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 63

Deklarata e fëmijës

1. Gjatë procesit të verifikimit të situatës së fëmijës nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, deklaratat e dhënë nga fëmija mund të administrohet *ex-officio* si një provë. Deklarata e fëmijës do të konsiderohet e vlefshme pavarësisht mënyrës së regjistrimit të saj, me shkrim apo me mjete audio-vizive, gjithmonë në prani të një psikologu dhe me pëlqimin e fëmijës mbi 10 vjeç.

2. Gjyqtari konsideron si provë deklaratën e dhënë nga fëmija gjatë procesit gjyqësor për vlefshmërinë dhe dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosje të fëmijës në përkujdesje alternative. Në rast se fëmija kërkon të dëgjohet, gjykata merr parasysh kërkesën e tij, e cila mund të rrëzohet veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim të motivuar.

Neni 64

Mbrojtja e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës kanë për të

detyrë të identifikojnë në mënyrë aktive dhe të trajtojnë me përparësi çdo rast të raportuar të fëmijës së shfrytëzuar, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Këto struktura janë përgjegjëse dhe kanë të drejtë të ndërmarrin veprime konkrete, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit, për largimin e fëmijës nga situata e shfrytëzimit ekonomik apo situata e rrugës. Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pas vlerësimit të secilit rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin teknik ndërsektorial përfshin në Planin Individual të Mbrojtjes, por pa u kufizuar në to:

a) marrjen e njëres nga masat e mbrojtjes së parashikuara në këtë ligj;

b) regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe/ose ndjekjen e rregullt të programit mësimor;

c) mbështetje mësimore, nëpërmjet mësuesve të posaçëm apo klasave të integruara;

ç) mosfrekuentimin e vendeve të caktuara;

d) këshillim psikologjik;

dh) trajtim shëndetësor, nëse është i nevojshëm.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në situatën familjare të fëmijës, mund të raportojë prindërit tek organet e policisë dhe të prokurorisë ose të përcaktojë një plan për aftësimin prindëror të prindërve të fëmijës, i cili përmban, por nuk kufizohet në:

a) ndjekjen e kurseve për aftësim prindëror;

b) ndjekjen e kurseve kundër alkoolizmit apo programeve kundër lëndëve narkotike e psikotrope;

c) mbështetjen për t'u regjistruar në njësinë vendore përkatëse dhe regjistrimin e gjithë anëtarëve të familjes në gjendjen civile;

ç) ndihmën për t'u integruar në skemën e ndihmës ekonomike;

d) ndihmën për aksesimin e tregut të punës;

dh) çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme, e cila ndihmon në përmirësimin e situatës familjare, duke krijuar premisa për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e mbarëvajtjes së Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe për ndryshimin e tij, duke përshtatur ose hequr çdo masë apo ndërhyrje nëse



situata që ka çuar në vendosjen e tyre ka ndryshuar. Në çdo rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës vë në dijeni drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në lidhje me zbatimin apo nevojën për ndryshimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 65

Mbrojtja e fëmijës nën moshën për përgjegjësi penale

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rastit të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin shumëdisiplinor për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, i cili përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrjet e shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij, duke marrë në konsideratë:

- a) kushtet, të cilat lehtësuan përfshirjen e fëmijës në krim;
- b) nivelin e rrezikshmërisë shoqërore dhe veprën e kryer;
- c) mjedisin, në të cilin është rritur dhe ka jetuar fëmija;
- ç) rrezikun apo mundësinë që fëmija të kryejë një veprë tjetër penale;
- d) çdo faktor tjetër, i cili mund të ndihmojë për të kuptuar situatën e fëmijës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të përshtihen në Planin Individual të Mbrojtjes edhe seanca këshillimi për prindërit e fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, të cilët nuk janë subjekt i një procedimi penal apo nuk janë dënuar penalisht për këtë gjë.

3. Veprimtaria e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 66

Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale

1. Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijën që dyshohet ose ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, zbatohet duke lejuar qëndrimin e fëmijës pranë familjes, me kusht që të mbikëqyren aktivitetet e mëposhtme:

- a) shkuarja në shkollë në mënyrë të rregullt;

b) pjesëmarrja në aktivitete të shërbimeve parashoqërore;

c) ndjekja e një trajtimi mjekësor apo këshillimi psikologjik;

ç) ndalimet për të shkuar apo frekuentuar vende të caktuara.

2. Në rast se është e pamundur që fëmija të lihet pranë familjes ose kur fëmija nuk përmbush kushtet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes, strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të propozojnë dhe të vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes, përfshirë edhe vendosjen e fëmijës te një nga të afërmit dhe duke i kërkuar fëmijës, në çdo rast, të respektojë kushtet e vendosura në Planin Individual të Mbrojtjes.

KREU VI

RAPORTIMI I RASTEVE TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

Neni 67

Detyrimi për raportim

1. Çdo person fizik ose juridik që ka informacion, ose vetë fëmija, duhet të njoftojë për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës institucionet qendrore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës ose Policinë e Shtetit.

2. Çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

3. Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin te strukturat për mbrojtjen e fëmijës.

4. Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë për detyrë të raportojnë menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës te fëmijët.



5. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha institucionet publike apo private të përkujdesjes së fëmijës, të arsimit e të shëndetësisë, për të lehtësuar raportimin.

6. Të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim, sipas këtij ligji, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës.

Neni 68

Linja e telefonit për fëmijë

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse, vendos në dispozicion një linjë telefoni pa pagesë, me numër të publikuar gjerësisht, e cila është e detyruar të verifikojë dhe të referojë pranë njërive për mbrojtjen e fëmijës apo strukturave të tjera kompetente çdo rast të raportuar.

KREU VII

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 69

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 32 e 33, të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

- a) personi fizik, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- b) personi juridik, nga 60 000 deri në 100 000 lekë;
- c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 60 000 deri në 80 000 lekë.

2. Çdo mospërbushje e detyrimeve ligjore nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës konsiderohet kundërvajtje administrative, sipas neneve 38, 39, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 57, 59, 60, 62, 64, 65, 66 e 67 të këtij ligji.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organi, i cili konstaton

kundërvajtjen administrative, vendos dhe ekzekuton sanksionet administrative.

4. Vendimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është titull ekzekutiv. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 70

Ankimi

Kundër vendimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas nenit 69, të këtij ligji, mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 6; 27, pika 4; 34, pikat 5 e 6; 35, pika 8; 38, pika 4; 40, pika 4; 44, pika 2; 45, pika 3; 52, pika 6; 54, pika 5; 64, pika 1; 65, pika 3; dhe 69, pika 5, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 40, pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministrat përgjegjës që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim neneve 8, pika 9; 32, pika 4; 48, pika 2; 49, pika 4; dhe 67, pika 7, të këtij ligji.

Neni 72

Shfuqizime

Ligji nr. 10 347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.



Neni 73
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10060, datë 6.3.2017,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 504 lekë